



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 06.03.2023)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z.Klodian Kurushi).

1.1 Për transferimin e përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë të gjyqtarit z. {...};

1.2 ”Për transferimin e përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë të gjyqtares znj. {...};

1.3 ”Për transferimin e përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë të gjyqtares znj. {...};

1.4 ”Për transferimin e përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë të gjyqtarit z. {...};

1.5 ”Për transferimin e përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë të gjyqtares znj. {...};

1.6 ”Për transferimin e përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë të gjyqtarit znj. {...}.

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 09:49 dhe mbaroi në orën 14:38.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Ilir Rusi* (zëvendëskryetar)
2. *Klodian Kurushi* (anëtar)
3. *Fatmira Luli* (anëtare)
4. *Irena Plaku* (anëtare)
5. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
6. *Ridvan Hado* (anëtar)
7. *Alban Toro* (anëtar)
8. *Marçela Shehu* (anëtare)
9. *Brikena Ukperaj* (anëtare)
10. *Yllka Rupa* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Valbona Bala, eksperte (EWMI-INL).*
5. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
6. *Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*
7. *Të tjerë: Paola Ndroqi (Universiteti “Epoka”), Edmond {...}j (Birn).*

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z.Klodian Kurushi).
 - 1.1 Për transferimin e përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë të gjyqtarit z.{...};

1.2 "Për transferimin e përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë të gjyqtares znj. {...};

1.3 "Për transferimin e përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë të gjyqtares znj. {...};

1.4 "Për transferimin e përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë të gjyqtarit z. {...};

1.5 "Për transferimin e përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë të gjyqtares znj. {...};

1.6 "Për transferimin e përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë të gjyqtarit znj. {...}.

Ilir Rusi: Përshëndetje!

Ju bëj me dije se Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor për arsye objektive e ka të pamundur për të qenë pjesë e kësaj mbledhjeje, kështu që nga ky moment e në vijim, mbledhjen e sotme do ta drejtoj unë. Njëkohësisht ju jeni bërë me dije edhe për rendin e ditës, edhe me pikat e shtuara në vijim të ditëve përkatëse.

Ka ndonjë diskutim nga anëtarët?

Po, zonja Shehu!

Marçela Shehu: Faleminderit!

Në kushtet kur Komisioni Disiplinor sot më datë 6, miratoi dhe kaloi për shqyrtim mbledhjes plenare 2 projektvendime, konkretisht projektvendimin "Për caktimin me short të relatorit të procedimit disiplinor nr. 1/2023 të filluar ndaj magjistratit zotit {...}, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor {...}" si dhe projektvendimin "Për caktimin me short të relatorit të procedimit disiplinor nr. 2/2023 të filluar ndaj magjistratit zotit {...}, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor {...}". Nga ana e Komisionit vlerësohet që këto çështje të përfshihen në rendin e ditës së sotme, me qëllim që të procedohet sa më shpejt me përcaktimin e relatorit dhe me hapat e mëtejshëm të procedimit disiplinor. Ky është propozimi im si kryetare e Komisionit, por ky është edhe qëndrimi i Komisionit.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Shehu!

Ka diskutime të tjera për këtë çështje?

(Nuk ka diskutime.)

Atëherë, hedhim në votim përfshirjen në rendin e ditës të çështjeve të prezantuara nga zonja Shehu.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Atëherë, në rendin e ditës përfshihen edhe çështjet e parashtruara nga zonja Shehu.

Në vijim të mbledhjes, për shkak edhe të natyrës së çështjeve që kemi për të diskutuar do të procedojmë rast pas rasti.

Fillojmë me pikën 1 të rendit të ditës, duke ia dhënë fjalën relatorit përkatës z. Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit!

Të nderuar kolegë, sot si Komision i Zhvillimit të Karrierës prezantojmë projektvendimet përkatëse që lidhen me transferimin e përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Bashkëlidhur këtyre projektvendimeve edhe relacioni përkatës që plotëson dhe përligj arsyen pse ne kemi kërkuar miratimin e projektvendimeve përkatëse.

Pa humbur kohë unë po prezantoj relacionin përkatës.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, me vendimet nr. 25-30, datë 18.01.2023, vendosi: “1. Hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. 2. Shpalljen e kërkesës për kandidatura, nga radhët e gjyqtarëve të gjykatave të shkallës së parë, për transferim të përkohshëm me pëlqim Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për pozicionet e lira përkatëse.”

Me këto vendime, Këshilli përcaktoi edhe afatin e paraqitjes së kërkesave për transferim të përkohshëm, pikërisht deri më datë 01.02.2023.

Brenda afati paraqitën kërkesa për transferim të përkohshëm 28 (njëzet e tetë) gjyqtarë dhe konkretisht:

- 1) Z. {...}, caktuar në pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier;
- 2) Z. {...}, caktuar në pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë;
- 3) Znj. {...}, caktuar në pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë;
- 4) Z. {...}, caktuar në pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër;
- 5) Znj. {...}, caktuar në pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat;
- 6) Znj. {...}, caktuar në pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë;
- 7) Znj. {...}, caktuar në pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier;
- 8) Znj. {...}, caktuar në pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë;
- 9) Znj. {...}, caktuar në pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier;
- 10) Z. {...}, caktuar në pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë;
- 11) Znj. {...}, caktuar në pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë;
- 12) Z. {...}, caktuar në pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin;
- 13) Z. {...}, caktuar në pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër;
- 14) Znj. {...}, caktuar në pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat;
- 15) Znj. {...}, caktuar në pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë;
- 16) Znj. {...}, caktuar në pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës;
- 17) Z. {...}, caktuar në pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë;
- 18) Z. {...}, caktuar në pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec, aktualisht me transferim të përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë;
- 19) Znj. {...}, caktuar në pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat;
- 20) Znj. {...}, caktuar në pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë;

- 21) Z. {...}, caktuar në pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier;
- 22) Znj. {...}, caktuar në pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin;
- 23) Znj. {...}, caktuar në pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier;
- 24) Znj. {...}, caktuar në pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër;
- 25) Znj. {...}, caktuar në pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë;

26) Z. {...}, caktuar në pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, ka depozituar në Këshill kërkues për transferim të përkohshëm në pozicionet e shpallura me vendimet nr.25-30 me datë 01.02.2023, ndërsa me kërkuesën e dërguar me postë elektronike më datë 13.02.2023 ka hequr dorë nga kandidimet e mësipërme.

- 27) Z. {...}, caktuar në pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë;
- 28) Z. {...}, caktuar në pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë.

Krahas kërkuesave për transferim të përkohshëm, 28 kandidatët kanë depozituar rregullisht të plotësuar edhe Deklaratën “Për dhënien e pëlqimit për transferim të përkohshëm” sipas formularit bashkëlidhur vendimeve të Këshillit nr. 25-30, datë 18.01.2023.

Verifikimi i kriterëve të transferimit -

Bazuar në nenin 7, të vendimit të Këshillit nr. 23, datë 07.02.2019, “Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit”, i ndryshuar, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës verifikoi paraprakisht plotësimin e kriterëve të transferimit nga gjyqtarët që kanë dhënë pëlqimin për transferim të përkohshëm.

Për verifikimin e kriterëve të transferimit Komisioni kërkoi dhe administroi informacion nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, dhe konkretisht:

1. Për Z. {...}:

Z. {...}, ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli “Jurist”, pranë Universitetit të Tiranës në datë 07.07.2000 dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2004.

2. Për Z. {...}:

Z. {...}, ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli “Jurist”, pranë Universitetit të Tiranës në datë 13.07.2010 dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës

në vitin 2020. Aktualisht ushtron funksionet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë, me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor të datës 27.10.2020.

3. Për Znj. {...}:

Znj. {...}, ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli “Jurist”, pranë Universitetit të Tiranës dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2013 *(në relacion referohet viti 2020)*.

4. Për Z. {...}:

Z. {...}, ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli “Jurist”, pranë Universitetit të Tiranës në vitin 2007 dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2012.

5. Për Znj. {...}:

Znj. {...}, ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli “Jurist”, pranë Universitetit të Tiranës në vitin 2008 dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2013.

6. Për Znj. {...}:

Znj. {...}, ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli “Jurist”, pranë Universitetit të Tiranës në korrik 2003 si dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2020.

7. Për Znj. {...}:

Znj. {...}, ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli “Jurist”, pranë Universitetit të Tiranës në vitin 2009 si dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2014.

8. Për Znj. {...}:

Znj. {...}, ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli “Jurist”, pranë Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi” në datën 25.07.2011, si dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2018.

9. Për Znj. {...}:

Znj. {...}, ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli “Jurist”, pranë Universitetit të Tiranës në datën 27.06.2011 dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2019.

10. Për Z. {...}:

Z. {...}, ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli “Jurist”, pranë Universitetit të Tiranës në vitin 2012 dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2018.

11. Për Znj. {...}:

Znj. {...}, ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli “Jurist”, pranë Universitetit të Tiranës në vitin 2010 si dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2018.

12. Për Z. {...}:

Z. {...}, ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli “Jurist”, pranë Universitetit “Luarasi” në vitin 2018 (*lapsus gjatë leximit, në vitin 2008*) dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2018.

13. Për Z. {...}:

Z. {...}, ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli “Jurist”, pranë Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi” në vitin 2012, ka përfunduar ciklin e dytë të Master-it në vitin 2014, si dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2019.

14. Për Znj. {...}:

Znj. {...}, ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli “Jurist”, pranë Universitetit të Tiranës në vitin 2012, ka përfunduar ciklin e dytë të studimeve Master pranë Universitetit të Tiranës në vitin 2014, si dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2019.

15. Për Znj. {...}:

Znj. {...}, ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli “Jurist”, pranë Universitetit të Tiranës në vitin 2002 dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2008.

16. Për Znj. {...}:

Znj. {...}, ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli “Jurist”, pranë Universitetit të Tiranës në vitin 2010 dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2016.

17. Për Z. {...}:

Z. {...}, ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli “Jurist”, pranë Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi” në vitin 2000. Me dekret të Presidentit të

Republikës datë 20.03.2007 ai është emëruar si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë.

18. Për Znj. {...}:

Znj. {...}, ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli “Jurist”, pranë Universitetit të Tiranës në vitin 2009 si dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2020.

19. Për Znj. {...}:

Znj. {...}, ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli “Jurist”, pranë Universitetit të Tiranës në vitin 2012, si dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2018.

20. Për Z. {...}:

Z. {...}, ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli “Jurist”, pranë Universitetit të Tiranës në vitin 2009, si dhe Shkollën e Magjistraturës në vitin 2022.

21. Për Znj. {...}:

Znj. {...}, ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli “Jurist”, pranë Universitetit të Tiranës në vitin 2011, si dhe Shkollën e Magjistraturës në vitin 2020.

22. Për Znj. {...}:

Znj. {...}, ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli “Jurist”, pranë Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi” në vitin 2006, ka përfunduar ciklin e dytë të studimeve Master në “E drejtë publike” në Universitetin e Tiranës në vitin 2015, si dhe Shkollën e Magjistraturës në vitin 2020.

23. Për Znj. {...}:

Znj. {...}, ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli “Jurist”, pranë Universitetit të Tiranës në vitin 2010 si dhe Shkollën e Magjistraturës në vitin 2015.

24. Për Znj. {...}:

Znj. {...}, ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli “Jurist”, pranë Universitetit të Tiranës në vitin 2010 si dhe Shkollën e Magjistraturës në vitin 2020.

25. Për Z. {...}:

Z. {...}, ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli “Jurist”, pranë Universitetit European të Tiranës në vitin 2012, ciklin e dytë të studimeve Master në

shkenca penale pranë Universitetit të Tiranës në vitin 2014, si dhe Shkollën e Magjistraturës në vitin 2019.

26. Për Z. {...}:

Z. {...}, ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli “Jurist”, pranë Universitetit të Tiranës në vitin 2009 dhe Shkollën e Magjistraturës në vitin 2020.

27. Për Z. {...}:

Z. {...}, ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli “Jurist”, pranë Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi” në vitin 2012, si dhe Shkollën e Magjistraturës në vitin 2019. Aktualisht zoti {...}, me vendimin nr. 365, datë 14.09.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor është transferuar nga Gjykata e Shkallës së Parë Pogradec përkohësisht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë, për një periudhë deri në 1 (një) vit. Më tej, me vendim nr. 390, datë 19.09.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor i përsëritet transferimi i përkohshëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë, për një periudhë deri në 01.05.2023, ku dhe aktualisht ai vazhdon të ushtrrojë detyrën e tij si gjyqtar pranë kësaj gjykate.

Gjithashtu, për verifikimin e kriterëve të transferimit, Komisioni administroi edhe mendimin e kryetarëve të gjykatave ku kandidatët ushtrojnë funksionet, konkretisht të gjithë gjykatat që unë i përmenda më lart dhe mendimet e kryetarëve për secilin nga gjyqtarët që unë i përmenda më lart. Janë të inkorporuara në relacionin përkatës dhe unë nuk po ndalem t’i lexoj një nga një.

Për të vijuar më tej, vlerësimi i Komisionit në lidhje me kandidaturat.

Kriteret ligjore të transferimit për gjyqtarët që kanë dhënë pëlqimin për transferim të përkohshëm, janë ato të përcaktuara në Rregulloren e Transferimit të Përkohshëm, si edhe në vendimet e Këshillit nr. 25-30, datë 18.01.2023, “Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe shpalljen e kërkesës për kandidaturë”. Këto kriterë parashikohen si më poshtë:

i) Transferimi i përkohshëm nuk cenon funksionimin e gjykatave ku kandidatët kanë caktimin e përhershëm;

ii) Dobia e transferimit të përkohshëm është më e madhe se efekti negativ që shkaktohet në gjykatat ku gjyqtarët ka caktimin e përhershëm;

iii) Kandidatët nuk janë të transferuar përkohësisht dhe as duke shërbyer në skemën e delegimit;

iv) Kandidatët nuk janë nën efektet e një mase disiplinore, zbatimi i së cilës mund të shmanget për shkak të transferimit të përkohshëm;

v) Në rast të transferimit, kandidatët nuk do të gjenden në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Këto kritere do të vlerësohen në mënyrë të veçantë nga ana e Komisionit. Në hartimin e këtij relacioni dhe projektakteve shoqëruese, Komisioni mban gjithashtu në vëmendje: i) Parashikimin sipas raportit të hartës së re gjyqësore; ii) mundësitë potenciale të lëvizjeve paralele; iii) kërkesat e gjykatave për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta.

Lidhur me cenimin e funksionimit të gjykatave ku kandidatët kanë caktimin e përhershëm:

Sa i përket cenimit/moscenimit të funksionimit të gjykatave respektive ku kandidatët kanë caktimin e përhershëm, nga transferimi i përkohshëm, Komisioni ka në konsideratë numrin e gjyqtarëve sipas organikave dhe atyre në detyrë në këto gjykata, sikundër edhe ngarkesën e tyre të punës në funksion të trupave gjykues në gjykimin e çështjeve gjyqësore.

Lidhur me këtë kriter konstatohet se gjyqtarët që kanë dhënë pëlqimin për transferim të përkohshëm kanë caktimin e përhershëm në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm si vijon:

1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier (5 kandidatë)
2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat (3 kandidatë)
3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër (3 kandidatë)
4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë (2 kandidatë)
5. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin (2 kandidatë)
6. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë (3 kandidatë)
7. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë (1 kandidat)
8. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë (1 kandidat)

9. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë (2 kandidatë)
10. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë (1 kandidat)
11. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë (2 kandidatë)
12. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës (1 kandidat)
13. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë (1 kandidat i cili hoqi dorë)
14. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec (1 kandidat, gjyqtar i transferuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë).

Sa i përket cenimit të funksionalitetit të gjykatave ku kandidatët kanë caktimin e përhershëm rezulton se:

1) Sa i përket Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, kjo gjykatë e ka organikën 14 gjyqtarë dhe aktualisht në këtë gjykatë ushtrojnë funksionin 10 gjyqtarë; Sipas raportit të vlerësimit të KLGJ për hartën e re gjyqësore, kjo gjykatë do të ketë në organikën e saj 21 gjyqtarë, duke u bashkuar me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, duke filluar nga 1 maj 2023. Transferimi i përkohshëm i deri 2 gjyqtarëve nuk do të cenonte funksionalitetin e kësaj gjykate, për më tepër kur kjo gjykatë në kohë të ndryshme ka funksionuar edhe me 5 (pesë) gjyqtarë. Ngarkesa e saj aktualisht është 1489 dosje me ngarkesë mesatare 148 dosje/gjyqtar.

2) Sa i përket Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, kjo gjykatë e ka organikën 10 gjyqtarë dhe aktualisht në këtë gjykatë ushtrojnë funksionin 7 gjyqtarë. Sipas raportit të vlerësimit të KLGJ për hartën e re gjyqësore, kjo gjykatë do të ketë në organikën e saj 9 gjyqtarë duke filluar nga 1 maj 2023. Transferimi i përkohshëm i 1 gjyqtari nuk do të passillte cenim të funksionalitetit të saj, ndërsa ajo do të vijonte të ruante funksionalitetin normal për të gjitha çështjet, për më tepër kur kjo gjykatë në kohë të ndryshme ka funksionuar edhe me 4 (katër) gjyqtarë. Ngarkesa e saj aktualisht është 1489 dosje me ngarkesë mesatare 212 dosje/gjyqtar.

3) Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër ka në organikën e saj 4 gjyqtarë dhe në detyrë janë 4 të tillë. Nisur nga kjo, mund të pranohet se transferimi i përkohshëm i një gjyqtari të kësaj gjykate nuk do të passillte cenim të rëndë të funksionalitetit të saj, ndërsa ajo do të vijonte të ruante një funksionalitet minimal. Pas hartës së re gjyqësore, kjo gjykatë bashkohet me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat, duke u krijuar Gjykata e Shkallës

së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, me 7 (shtatë) gjyqtarë. Ngarkesa e saj aktualisht është 288 çështje ose rreth 72 çështje/gjyqtar.

4) Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë ka në organikën e saj 5 gjyqtarë dhe në detyrë janë 3 të tillë. Sipas raportit të vlerësimit të KLGJ për hartën e re gjyqësore, kjo gjykatë do të bashkohet me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier duke u parashikuar organika me 21 gjyqtarë, duke filluar nga 1 maj 2023. Nisur nga kjo, mund të pranohet se transferimi i përkohshëm i një gjyqtari të kësaj gjykate nuk do të passillte cenim të funksionalitetit të saj, ndërsa ajo do të vijonte të ruante funksionalitet normal për çështjet që gjykohen me 1 gjyqtar, deri më 30 prill 2023; Ngarkesa e saj aktualisht është 592 çështje ose rreth 197 çështje/gjyqtar.

5) Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin ka në organikën e saj 4 gjyqtarë, ndërsa në detyrë janë 4 të tillë (deri në mars 2023 kur parashikohet të dalë në pension gjyqtari {...}). Sipas raportit të vlerësimit të KLGJ për hartën e re gjyqësore, kjo gjykatë do të bashkohet me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë duke u parashikuar organika me 12 gjyqtarë; Nisur nga sa më sipër, mund të vlerësohet se transferimi i përkohshëm i një gjyqtari të kësaj gjykate nuk do të passillte cenim të rëndë të funksionalitetit të saj, ndërsa ajo nuk do të vijonte të ruante funksionalitetin për çështjet që gjykohen me trup gjykues të përbërë nga 3 gjyqtarë. Ngarkesa e saj aktualisht është 308 çështje ose mesatarisht rreth 77 çështje/gjyqtar.

6) Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë ka në organikën e saj 6 gjyqtarë dhe në detyrë janë 5 të tillë. Sipas raportit të vlerësimit të KLGJ për hartën e re gjyqësore, kjo gjykatë do të ketë në organikën e saj 7 anëtarë. Nisur nga kjo, mund të pranohet se transferimi i përkohshëm i një gjyqtari të kësaj gjykate nuk do të passillte cenim të rëndë të funksionalitetit të saj, ndërsa ajo do të vijonte të ruante një funksionalitet minimal. Ngarkesa e saj aktualisht është 1195 çështje ose rreth 239 çështje/gjyqtar.

7) Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë ka në organikën e saj 5 gjyqtarë dhe në detyrë janë 3 të tillë. Sipas raportit të vlerësimit të KLGJ për hartën e re gjyqësore, kjo gjykatë do të bashkohet me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë duke u parashikuar organika me 12 gjyqtarë. Në kushtet aktuale, mund të pranohet se transferimi i përkohshëm i një gjyqtari të kësaj gjykate nuk do të passillte cenim të funksionalitetit të saj për çështjet që gjykohen me 1 gjyqtar, por nuk do të vijonte të ruante as një

funksionalitet minimal për çështjet që gjykohen me trup gjykues të përbërë nga 3 gjyqtarë, deri më 30 prill 2023. Ngarkesa e saj aktualisht është 850 çështje ose rreth 283 çështje/gjyqtar.

8) Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë ka në organikën e saj 4 gjyqtarë dhe në detyrë janë 2 të tillë. Sipas raportit të vlerësimit të KLGJ për hartën e re gjyqësore, kjo gjykatë do të bashkohet me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër duke u parashikuar organika me 18 gjyqtarë. Nisur nga kjo, mund të pranohet se transferimi i përkohshëm i një gjyqtari të kësaj gjykate do të passillte cenim të funksionalitetit të saj, duke sjellë edhe mungesën e organizimit të shortit për ndarjen e çështjeve gjyqësore, ndërsa ajo nuk do të as aktualisht nuk gëzon funksionalitet minimal për çështjet që gjykohen me trup gjykues të përbërë nga 3 gjyqtarë. Ngarkesa e saj aktualisht është 286 çështje ose rreth 143 çështje/gjyqtar.

9) Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë ka në organikë 14 gjyqtarë dhe aktualisht në këtë gjykatë ushtrojnë funksionin 7 gjyqtarë. Sipas raportit të vlerësimit të KLGJ për hartën e re gjyqësore, kjo gjykatë do të bashkohet me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec duke u parashikuar organika me 16 gjyqtarë, dhe transferimi i përkohshëm i 1 gjyqtari nuk do të passillte cenim të funksionalitetit të saj, ndërsa ajo do të vijonte të ruante funksionalitetin normal për të gjitha çështjet, për më tepër kur kjo gjykatë në kohë të ndryshme ka funksionuar edhe me 5 (pesë) gjyqtarë. Ngarkesa e saj aktualisht është 1533 çështje ose rreth 219 çështje/gjyqtar.

10) Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë – kjo gjykatë ka në organikën e saj 4 gjyqtarë dhe aktualisht në këtë gjykatë ushtrojnë funksionin 5 gjyqtarë. Kjo gjykatë është konsideruar nga Këshilli si “gjykatë në nevojë” dhe 2 prej gjyqtarëve që ushtrojnë detyrën në këtë gjykatë janë me transferim të përkohshëm. Transferimi i 1 gjyqtari do të rëndonte pasojat e cenimit të funksionalitetit të saj, nisur nga ngarkesa e konsiderueshme.

11) Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë ka në organikën e saj 4 gjyqtarë dhe aktualisht në këtë gjykatë ushtrojnë funksionin 3 të tillë (pasi 1 prej gjyqtarëve të kësaj gjykate është transferuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës). Sipas raportit të vlerësimit të KLGJ për hartën e re gjyqësore, kjo gjykatë do të bashkohet me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës duke u parashikuar organika me 7 gjyqtarë. Kjo gjykatë ka një numër të ulët çështjesh të regjistruara, 113 çështje, dhe për pasojë dobia e transferimit të përkohshëm të 1 gjyqtari është më e madhe se efekti negativ që do shkaktohet në

gjykatat ku gjyqtarët ka caktimin e përhershëm. Ngarkesa e saj aktualisht është 113 çështje ose rreth 56 çështje/gjyqtar;

12) Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës e ka organikën 17 gjyqtarë dhe aktualisht në këtë gjykatë ushtrojnë funksionin 8 gjyqtarë. Kjo gjykatë është konsideruar nga Këshilli si “gjykatë në nevojë” dhe për këtë arsye Këshilli ka nisur procedurat e lëvizjes paralele me vendimet nr.21-24 datë 18.01.2023, si edhe transferimet e përkohshme në këtë gjykatë me vendimet nr.31-32 datë 18.01.2023. Në këto rrethana transferimi i 1 gjyqtari do të rëndonte edhe më tej pasojat në ngarkesën dhe funksionalitetin normal të kësaj gjykate.

13) Sa i përket Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, në kushtet kur z. {...} ka hequr dorë nga kandidimet e tij për transferim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, kjo gjykatë nuk do të merret në analizë.

14) Sa i përket Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, nuk analizohet funksionaliteti i kësaj gjykate pasi z. {...} (i cili ka caktim të përhershëm në këtë gjykatë) kandidon në këtë procedurë transferimi të përkohshëm ne mendojmë se skualifikohet për shkak të kriterëve ndaluese siç do të argumentohet në vijim në këtë relacion dhe e përmendëm edhe në kriteret e kandidimit më lart.

Nisur nga kjo analizë referuar kriterit të funksionalitetit të gjykatës nga transferimi i përkohshëm, Komisioni vlerëson se kandidatët që e plotësojnë atë, i përkasin: Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

Lidhur me kriterin e dobisë më të madhe të transferimit të përkohshëm në raport me efektin negativ që shkaktohet në gjykatat ku gjyqtarët kanë caktimin e përhershëm:

Sa i përket kriterit të dobisë më të madhe të transferimit të përkohshëm në raport me efektin negativ që shkaktohet në gjykatat ku gjyqtarët kanë caktimin e përhershëm, Komisioni ka në konsideratë numrin e gjyqtarëve në detyrë në gjykatën ku synohet bërja e transferimit të përkohshëm dhe ngarkesën e punës së saj në raport numrin e gjyqtarëve në detyrë në gjykatat ku kandidatët kanë caktimin e përhershëm dhe ngarkesën e punës në këto gjykata.

Lidhur me këtë kriter konstatohet se:

Në Gjykatën Rrethit Gjyqësor Tiranë aktualisht janë në detyrë 36 gjyqtarë, nga 76 të tillë sipas organikës së kësaj gjykate. Aktualisht ngarkesa e çështjeve gjyqësore pranë kësaj gjykate është si vijon më poshtë: Totali i çështjeve është 19374; Nr. çështjeve të regjistruara të reja (nga data 01 janar) është 29020; Nr. çështjeve të gjykuara 28098 dhe Nr. çështjeve në shqyrtim është 20299. Aktualisht, ngarkesa e gjyqtarëve në këtë gjykatë varion minimalisht për gjyqtar nga 105 çështje (dhoma penale) në maksimalisht në 1533 çështje për gjyqtar në dhomën civile. Numri i çështjeve është rreth 563 çështje për gjyqtar. Në supozimin e ushtrimit të detyrës edhe të 6 gjyqtarëve prej transferimit të përkohshëm në këtë gjykatë, në pikëpamje të ngarkesës së punës, teorikisht, secili prej tyre do të kishte mesatarisht rreth 483 çështje. Nisur nga kjo, në pikëpamje të ngarkesës së punës, në rastin e transferimit të përkohshëm të 6 gjyqtarëve në këtë gjykatë, ngarkesa e punës do të shpërndahej midis 42 gjyqtarëve, duke reduktuar ndjeshëm ngarkesën e gjyqtarëve në detyrë, me rreth 483 çështje secili, në supozimin e vijimit të të njëjtit trend të çështjeve të regjistruara rishtazi, çka vlerësohet si një impakt pozitiv shumë i lartë.

Nga ana tjetër, nën supozimin e transferimit të përkohshëm të 6 gjyqtarëve, në pikëpamje të funksionalitetit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë do të përmirësonte ndjeshëm ngarkesën në dhomën civile;

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier ka në detyrë 10 gjyqtarë, ndërsa ngarkesa e saj (shkurt 2023) është 1489 çështje ose rreth 148 çështje për gjyqtar. Në supozimin e transferimit të përkohshëm të një gjyqtari nga kjo gjykatë, në pikëpamje të ngarkesës së punës, ajo do të shpërndahej midis 9 gjyqtarëve, me një ngarkese prej rreth 165 çështje për gjyqtar, çka do të çonte në rritjen e ngarkesës së gjyqtarëve në detyrë pranë saj me rreth 17 çështje secili, impakt negativ ky që vlerësohet shumë më i ulët se impakti pozitiv që do të shkaktonte transferimi i përkohshëm i një gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Nga ana tjetër, mbajtur në konsideratë se kjo gjykatë ka numrin më të madh të kandidatëve, dhe gjykata potenciale për transferim me numrin më të lartë të organikës, në supozimin e transferimit të 2 gjyqtarëve nga kjo gjykatë, duke arritur ngarkesa në 185 çështje/gjyqtar, rritjen e ngarkesës së gjyqtarëve në detyrë pranë saj me rreth 37 çështje secili, sërish krijon një impakt në dukje negativ në këtë gjykatë, por kjo do të konsiderohej i ulët me impaktin pozitiv që do të sillte në gjykatën ku do të

transferoheshin të dy gjyqtarët; Rrjedhimisht Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier do të vijonte të ruante funksionalitet optimal për gjykimin e çështjeve të tjera;

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat ka në detyrë 7 gjyqtarë, ndërsa ngarkesa e saj (shkurt 2023) është 1471 çështje ose rreth 210 çështje për gjyqtar. Në supozimin e transferimit të përkohshëm të një gjyqtari nga kjo gjykatë, në pikëpamje të ngarkesës së punës, ajo do të shpërndahej midis 6 gjyqtarëve, me një ngarkesë prej 245 çështje për gjyqtar, çka do të çonte në rritjen e ngarkesës së gjyqtarëve në detyrë pranë saj me rreth 35 çështje secili, impakt negativ ky që mund të vlerësohet më i ulët se impakti pozitiv që do të shkaktonte transferimi i përkohshëm i një gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Nga ana tjetër, në pikëpamje të funksionalitetit, nën këtë supozim, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat do të vijonte të ruante një funksionalitet të optimal, duke plotësuar nevojat për gjykimin e çështjeve penale në përgjithësi apo dhe atyre civile që gjykohen me trup gjykues të formuar nga tre gjyqtarë.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër ka në detyrë 4 gjyqtarë, ndërsa ngarkesa e saj (shkurt 2023) është 288 çështje ose rreth 72 çështje për gjyqtar. Në supozimin e transferimit të përkohshëm të një gjyqtari nga kjo gjykatë, në pikëpamje të ngarkesës së punës, ajo do të shpërndahej midis 3 gjyqtarëve, me një ngarkesë prej rreth 96 çështje për gjyqtar, çka do të çonte në rritjen e ngarkesës së gjyqtarëve në detyrë pranë saj me rreth 24 çështje secili, impakt negativ ky që vlerësohet shumë më i ulët se impakti pozitiv që do të shkaktonte transferimi i përkohshëm i një gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Nga ana tjetër, nën këtë supozim, në pikëpamje të funksionalitetit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër do të vijonte të ruante funksionalitet minimal për çështjet me trup gjykues me 3 gjyqtarë;

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë ka në detyrë 3 gjyqtarë, ndërsa ngarkesa e saj (shkurt 2023) është 113 çështje ose rreth 38 çështje për gjyqtar. Në supozimin e transferimit të përkohshëm të një gjyqtari nga kjo gjykatë, në pikëpamje të ngarkesës së punës, ajo do të shpërndahej midis 2 gjyqtarëve, me një ngarkesë prej rreth 56 çështje për gjyqtar, çka do të çonte në rritjen e ngarkesës së gjyqtarëve në detyrë pranë saj me rreth 18 çështje secili, impakt negativ ky që vlerësohet shumë më i ulët se impakti pozitiv që do të shkaktonte transferimi i përkohshëm i një gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Nga ana tjetër, nën këtë supozim, në pikëpamje të funksionalitetit, Gjykata e

Rrethit Gjyqësor Tropojë do të vijonte të ruante funksionalitet minimal për çështjet me që gjykohen me 1 anëtar.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë ka në detyrë 3 gjyqtarë, ndërsa ngarkesa e saj (shkurt 2023) është 592 çështje ose rreth 197 çështje/gjyqtar. Në supozimin e transferimit të përkohshëm të një gjyqtari nga kjo gjykatë, në pikëpamje të ngarkesës së punës, ajo do të shpërndahej midis 2 gjyqtarëve. Pas hartës së re gjyqësore ngarkesa e gjyqtarëve edhe në supozimin e transferimeve nga gjykata e Fierit do të arrinte 206 dosje/gjyqtar, një ngarkesë pa ndikim me atë aktualen, impakt negativ ky që vlerësohet shumë më i ulët se impakti pozitiv që do të shkaktonte transferimi i përkohshëm i një gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Efekti i transferimit të një gjyqtari do të ishte i ndjeshëm vetëm deri në 30 prill 2023. Nga ana tjetër, nën këtë supozim, në pikëpamje të funksionalitetit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë do të vijonte të ruante funksionalitet minimal për çështjet me që gjykohen me 1 gjyqtar.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë ka në detyrë 7 gjyqtarë, ndërsa ngarkesa e saj (shkurt 2023) është 1533 çështje ose rreth 219 çështje për gjyqtar. Në supozimin e transferimit të përkohshëm të një gjyqtari nga kjo gjykatë, në pikëpamje të ngarkesës së punës, ajo do të shpërndahej midis 6 gjyqtarëve, me një ngarkesë prej rreth 255 çështje për gjyqtar, çka do të çonte në rritjen e ngarkesës së gjyqtarëve në detyrë pranë saj me rreth 36 çështje secili, impakt negativ ky që vlerësohet shumë më i ulët se impakti pozitiv që do të shkaktonte transferimi i përkohshëm i një gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Në pikëpamje të funksionalitetit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë do të vijonte të ruante funksionalitet optimal për çështjet me trup gjykues me 3 gjyqtarë. Sipas raportit të KLGJ-së për hartën e re gjyqësore, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, do ti bashkohet edhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec, duke arritur ngarkesa në 227 dosje për gjyqtar. Në hipotezën e transferimit të një gjyqtari nga kjo gjykatë në rastin kur dy gjykatat do të funksiononin me qendër në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë, ngarkesa do të shkonte në një numër mesatar prej 256 dosje për gjyqtar.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin ka në detyrë 4 gjyqtarë, ndërsa ngarkesa e saj (shkurt 2023) është 308 çështje ose rreth 77 çështje për gjyqtar. Në supozimin e transferimit të përkohshëm të një gjyqtari nga kjo gjykatë, në pikëpamje të ngarkesës së punës, ajo do të shpërndahej midis 3 gjyqtarëve fillimisht me një ngarkesë prej rreth

102 çështje për gjyqtar, impakt negativ ky që vlerësohet më i ulët se impakti pozitiv që do të shkaktonte transferimi i përkohshëm i një gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Nga ana tjetër, nën këtë supozim, në pikëpamje të funksionalitetit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin do të vijonte të ruante funksionalitet minimal për çështjet që gjykohen me trup gjykues me 3 gjyqtarë;

Lidhur me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë, nëse do të supozohej transferimi i 1 gjyqtari: Në analizë të ndikimit të hartës së re gjyqësore dhe në supozimin e transferimit të 1 gjyqtari nga gjykata Kurbin në Durrës, situata nuk do të ishte optimiste për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë, pasi ngarkesa do të arrinte në 289 dosje/gjyqtar. Këtu merret në konsideratë edhe fakti që për z. {...} përfundon statusi i magjistratit për shkak të daljes në pension në mars 2023. Gjykata e juridiksionit të përgjithshëm Lezhë do të kishte në organikë vetëm 4 gjyqtarë. Në kushtet aktuale, mund të pranohet se transferimi i përkohshëm i një gjyqtari të kësaj gjykate nuk do të passillte cenim të funksionalitetit të saj për çështjet që gjykohen me 1 gjyqtar, por nuk do të vijonte të ruante asnjë funksionalitet minimal për çështjet që gjykohen me trup gjykues të përbërë nga 3 gjyqtarë, deri më 30 prill 2023. Ngarkesa e saj aktualisht është 850 çështje ose rreth 283 çështje/gjyqtar.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë ka në detyrë 5 gjyqtarë, ndërsa ngarkesa e saj (shkurt 2023) është 1195 çështje ose rreth 239 çështje për gjyqtar. Në supozimin e transferimit të përkohshëm të një gjyqtari nga kjo gjykatë, në pikëpamje të ngarkesës së punës, ajo do të shpërndahej midis 4 gjyqtarëve, me një ngarkese prej rreth 299 çështje për gjyqtar, çka do të çonte në rritjen e ngarkesës së gjyqtarëve në detyrë pranë saj me rreth 60 çështje secili, impakt negativ ky që vlerësohet shumë më i ulët se impakti pozitiv që do të shkaktonte transferimi i përkohshëm i një gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Nga ana tjetër, nën këtë supozim, në pikëpamje të funksionalitetit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë do të vijonte të ruante funksionalitet minimal për çështjet me trup gjykues me 3 gjyqtarë;

Për sa më sipër, referuar kriterit të dobishmërisë së transferimit të përkohshëm, Komisioni vlerëson se kandidatët plotësojnë këtë kriter.

Lidhur me kriterin e mosqenies i transferuar përkohësisht, apo duke shërbyer në skemën e delegimit:

Sa i përket kriterit të mosqenies të transferuar përkohësisht dhe as duke shërbyer në skemën e delegimit, Komisioni ka në konsideratë informacionin e administruar nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, si më lart parashtruar, nga rezulton se kandidati {...} gjendet në kushtet e kriterit ndalues të qenies i transferuar përkohësisht. Konkretisht, me vendim nr. 390, datë 19.09.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor i përsëritet transferimi i përkohshëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë, për një periudhë deri në 01.05.2023, ku dhe aktualisht vazhdon të ushtrojë detyrën.

Lidhur me kriterin e mosqenies nën efektet e një mase disiplinore, zbatimi i së cilës mund të shmanget për shkak të transferimit të përkohshëm:

Sa i përket kriterit këtij kriteri, Komisioni ka në konsideratë informacionin e administruar nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, si më lart parashtruar, asnjë prej kandidatëve nuk gjendet në kushtet e këtij kriteri ndalues.

Lidhur me kriterin e mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale:

Komisioni edhe në këtë rast ka marrë në konsideratë vetëdeklarimin e bërë nga kandidatët në kuadër të kandidimit për transferim të përkohshëm, përveç dhe mungesën e ndonjë të dhëne në këtë drejtim. Nisur nga këto, Komisioni vlerëson se kandidatët nuk gjenden në kushtet e këtij kriteri ndalues.

Lidhur me përzgjedhjen e kandidatit që duhet të transferohet përkohësisht, Komisioni mban në konsideratë përcaktimet e pikave 3, 4 dhe 5, të nenit 4, të Rregullores së Transferimit të Përkohshëm, sipas të cilave: "...3. Transferimi i përkohshëm i gjyqtarit nuk kryhet nëse efekti negativ që shkakton në gjykatën e tij, çmohet nga Këshilli se, është më i madh se dobia që ai pritët të sjellë në gjykatën ku do të transferohet. Për këtë qëllim Këshilli në çdo rast merr mendimin e kryetarit të gjykatës ku gjyqtari është i caktuar në mënyrë të përhershme. 4. Transferimi i përkohshëm, si rregull, bëhet ndërmjet gjyqtarëve nga gjykatat me ngarkesë më të ulët, duke filluar nga gjykatat më të afërta apo ato brenda të njëjtit juridiksion apelit me gjykatën në nevojë. Përgjithësisht, nëse transferimi i përkohshëm sipas këtij rregulli do të cenonte funksionalitetin e gjykatave me ngarkesë më të ulët, transferimi mund të bëhet nga gjyqtarët e gjykatave të tjera, por në çdo rast duke respektuar parimin sipas pikës 3 të këtij neni. 5. Në rast se ka më shumë se një

gjqtar që jep pëlqimin për transferim të përkohshëm në një gjykatë konkrete, Këshilli vendos të përzgjedhë atë kandidat që vjen nga gjykata me ngarkesën mesatare më të ulët për gjyqtar. Në rast se kandidatët vijnë nga e njëjta gjykatë, Këshilli përzgjedhë kandidatin duke marrë në konsideratë përvojën profesionale të gjyqtarëve dhe fushën e së drejtës për të cilën kërkohet shërbimi i tij.”.

Lidhur me përzgjedhjen e kandidatit që duhet të transferohet përkohësisht, Komisioni mban në konsideratë përcaktimet e pikës 3, të nenit 8, të Rregullores së Transferimit të Përkohshëm, sipas së cilës: “...3. Në përfundim të shqyrtimit të rasteve të cilët kanë dhënë pëlqimin për transferim të përkohshëm, bazuar në ndikimin e transferimit, në ngarkesën e gjyqtarit që ka dhënë pëlqimin, si dhe në përvojën profesionale të tij në raport me fushën e së drejtës për të cilën kërkohet shërbimi, Komisioni përgatit një raport për çdo rast dhe ia paraqet Këshillit për shqyrtim duke propozuar: a) miratimin e transferimit të përkohshëm; b) refuzimin e transferimit të përkohshëm”.

Nga sa u parashtrua, fillimisht, përmes zbatimit të kriterëve të përcaktuar nga ligji dhe Rregullorja e Transferimit të Përkohshëm, Komisioni identifikon gjykatat nga duhet të bëhet transferimi i përkohshëm i një gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kështu, nga zbatimi i kriterit të “gjykatës me ngarkesë më të ulët”, si dhe atij të “dobishmërisë së transferimit”, renditja e gjykatave nga kandidatët vijon të rezultojë si më poshtë:

1) Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë; 2) Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër; 3) Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier; 4) Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë; 5) Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat; 6) Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin; 7) Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë; 8) Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë.

Për sa më sipër, në kushtet kur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë do të transferohen vetëm 6 (gjashtë) gjyqtarë, gjykatat nga ku do të transferohen gjyqtarët janë: i) Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier; ii) Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat; iii) Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër; iv) Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë; v) Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

Gjykatat të cilat nuk u përfshinë në këtë renditje, do të merren në konsideratë në projekt-aktet për transferimin e përkohshëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës.

Nisur nga sa më sipër, identifikohet si një prej gjykatave nga ku duhet të bëhet transferimi i përkohshëm i një gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, pra Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, gjykatë e cila për shkak të organikës, ngarkesës dhe afërsisë gjeografike është gjykatë e cila mundëson transferimin e deri në 2 gjyqtarëve.

Në kushtet kur nga kjo gjykatë janë pesë kandidatë, për të identifikuar gjyqtarin që duhet të transferohet përkohësisht u zbatuan kriteret e përzgjedhjes sipas Rregullores së Transferimit të Përkohshëm. Referuar këtyre të fundit rezultoi se kandidatët znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}, znj. {...} dhe z. {...} plotësojnë në të njëjtën masë kriteret e “ndikimit të transferimit” dhe të “ngarkesës”. Për të identifikuar mes tyre gjyqtarin që duhet të transferohet përkohësisht në rastin konkret, u konsiderua masa e përvojës profesionale.

Mbajtur në konsideratë përcaktimin e pikës 5 të Nenit 4 të rregullores “Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit”: “... Në rast se kandidatët vijnë nga e njëjta gjykatë, Këshilli përzgjedhë kandidatin duke marrë në konsideratë përvojën profesionale të gjyqtarëve dhe fushën e së drejtës për të cilën kërkohet shërbimi i tij”, rezultoi se gjyqtarët z. {...} dhe znj. {...} kanë përvojën më të gjatë, përkatësisht për z. {...} vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 19 vite dhe për znj. {...} vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 9 vite. Ndërsa për kandidaten znj. {...} është 3 vjet; për znj. {...} 2 vjet; z. {...} 0 vite.

Mbi sa më lart, referuar kriterit të përzgjedhjes së “përvojës profesionale në fushën e të drejtës për të cilën kërkohet shërbimi”, gjyqtarët që duhet të transferohet përkohësisht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë rezultoi të jetë z. {...} e në vijim znj. {...}.

Mbi këtë bazë, Komisioni ka përgatitur dhe i propozon Këshillit projektvendimet “Për transferimin e përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë të gjyqtarit z. {...}” dhe “Për transferimin e përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë të gjyqtarës znj. {...}”.

Vijojmë me gjykatën tjetër e cila identifikohet si një prej gjykatave nga ku duhet të bëhet transferimi i përkohshëm i një gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, pra Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat.

Në kushtet kur nga kjo gjykatë janë 3 (tre) kandidatë, për të identifikuar gjyqtarin që duhet të transferohet përkohësisht u zbatuan kriteret e përzgjedhjes sipas Rregullores së Transferimit të Përkohshëm. Referuar këtyre të fundit rezultoi se kandidatët znj. {...}, znj. {...} dhe znj. {...} plotësojnë në të njëjtën masë kriteret e “ndikimit të transferimit” dhe të “ngarkesës”. Për të identifikuar mes tyre gjyqtarin që duhet të transferohet përkohësisht në rastin konkret, u konsiderua masa e përvojës profesionale.

Mbajtur në konsideratë përcaktimin e pikës 5 të Nenit 4 të rregullores së përmendur më lart, rezultoi se znj. {...} ka përvojën më të gjatë, përkatësisht për znj. {...} vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 10 vite, për znj. {...} është 3 vite dhe për znj. Gjoni është 2 vite.

Mbi sa më sipër, referuar kriterit të përzgjedhjes së “përvojës profesionale në fushën e të drejtës për të cilën kërkohet shërbimi”, gjyqtari që duhet të transferohet përkohësisht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë rezultoi të jetë znj. {...}.

Mbi këtë bazë, Komisioni ka përgatitur dhe i propozon Këshillit projektvendimin “Për transferimin e përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë të gjyqtares znj. {...}”.

Vijojmë me gjykatën tjetër e cila identifikohet si një prej gjykatave nga ku duhet të bëhet transferimi i përkohshëm i një gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, pra Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër.

Në kushtet kur nga kjo gjykatë janë 3 (tre) kandidatë, për të identifikuar gjyqtarin që duhet të transferohet përkohësisht edhe në këtë rast u zbatuan kriteret e përzgjedhjes sipas Rregullores së Transferimit të Përkohshëm. Referuar këtyre të fundit rezultoi se kandidatët z. {...}, znj. {...} dhe z. {...} plotësojnë në të njëjtën masë kriteret e “ndikimit të transferimit” dhe të “ngarkesës”. Për të identifikuar mes tyre gjyqtarin që duhet të transferohet përkohësisht në rastin konkret, u konsiderua masa e përvojës profesionale.

Mbajtur në konsideratë përcaktimin e pikës 5 të Nenit 4 të rregullores së përmendur më lart, rezultoi se z. {...} ka përvojën më të gjatë, përkatësisht për z. {...} vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 11 vite, për znj. {...} është 8 vite dhe për z. {...} është 3 vite.

Mbi sa më sipër, referuar kriterit të përzgjedhjes së “përvojës profesionale në

fushën e të drejtës për të cilën kërkohet shërbimi”, gjyqtari që duhet të transferohet përkohësisht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë rezulton të jetë z. {...}.

Mbi këtë bazë, Komisioni ka përgatitur dhe i propozon Këshillit projektvendimin “Për transferimin e përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë të gjyqtarit z. {...}”.

Vijojmë me gjykatën tjetër e cila identifikohet si një prej gjykatave nga ku duhet të bëhet transferimi i përkohshëm i një gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, pra Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë.

Në kushtet kur nga kjo gjykatë janë 2 (dy) kandidatë, për të identifikuar gjyqtarin që duhet të transferohet përkohësisht edhe në këtë rast u zbatuan kriteret e përzgjedhjes sipas Rregullores së Transferimit të Përkohshëm. Referuar këtyre të fundit rezulton se kandidatët znj. {...} dhe z. {...} plotësojnë në të njëjtën masë kriteret e “ndikimin e transferimit” dhe të “ngarkesës”. Për identifikuar mes tyre gjyqtarin që duhet të transferohet përkohësisht në rastin konkret, u konsiderua masa e përvojës profesionale.

Mbajtur në konsideratë përcaktimin e pikës 5 të Nenit 4 të rregullores së përmendur më lart, rezulton se znj. {...} ka përvojën më të gjatë, përkatësisht për znj. {...} vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 3 vite, për z. {...} është 2 vite.

Mbi sa më lart, referuar kriterit të përzgjedhjes së “përvojës profesionale në fushën e të drejtës për të cilën kërkohet shërbimi”, gjyqtari që duhet të transferohet përkohësisht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë rezulton të jetë znj. {...}.

Mbi këtë bazë, Komisioni ka përgatitur dhe i propozon Këshillit projektvendimin “Për transferimin e përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë të gjyqtares znj. {...}”.

Vijojmë me gjykatën tjetër e cila identifikohet si një prej gjykatave nga ku duhet të bëhet transferimi i përkohshëm i një gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, pra Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, pasi ndikimi i transferimit të një gjyqtari nga kjo gjykatë pas implementimit të hartës së re gjyqësore ka më tepër dobi, se gjyqtarët që i përkasin gjykatave të tjera.

Në kushtet kur nga kjo gjykatë janë 2 (dy) kandidatë, për të identifikuar gjyqtarin që duhet të transferohet përkohësisht edhe në këtë rast u zbatuan kriteret e përzgjedhjes sipas Rregullores së Transferimit të Përkohshëm. Referuar këtyre të fundit rezulton se

kandidatët znj. {...} dhe znj. {...} plotësojnë në të njëjtën masë kriteret e “ndikimin e transferimit” dhe të “ngarkesës”. Për identifikuar mes tyre gjyqtarin që duhet të transferohet përkohësisht në rastin konkret, u konsiderua masa e përvojës profesionale.

Mbajtur në konsideratë përcaktimin e pikës 5 të Nenit 4 të rregullores së mësipërme, rezulton se gjyqtarja {...} ka përvojën më të gjatë profesionale, përkatësisht për znj. {...} vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 15 vite, për znj. {...} është 2 vite.

Mbi sa më lart, referuar kriterit të përzgjedhjes së “përvojës profesionale në fushën e të drejtës për të cilën kërkohet shërbimi”, gjyqtari që duhet të transferohet përkohësisht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë rezulton të jetë znj. {...}.

Mbi këtë bazë, Komisioni ka përgatitur dhe i propozon Këshillit projektvendimin “Për transferimin e përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë të gjyqtarës znj. {...}”.

Struktura e projektvendimit

Projektvendimet e sipërcituara janë strukturuar në 6 pika.

Sipas pikës 1 të projektvendimeve propozohet transferimi i përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë të gjyqtarëve z. {...}/ znj. {...}/ znj. {...}/ z. {...}/ znj. {...}/ znj. {...}, për një periudhë deri në një vit, që mund të ndërpritet në rast të ndryshimit të rrethanave që kushtëzuan transferimin. Periudha e transferimit është propozuar një vit, pra në afatin maksimal sipas pikës 6, të nenit 46, të Ligjit për Statusin, duke u mbajtur në konsideratë situata në të cilën gjendet aktualisht gjykata në nevojë, pra Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, situatë e cila pritet të jetë e tillë edhe në vijim, ndërsa vakancat në këtë gjykatë janë krijuar: 1) për shkak të mosplotësimit të vakancave të përhershme; 2) për shkak të pezullimit nga detyra “ex lege”, të gjyqtarëve, si rezultat shkarkimit nga detyra me vendim të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (18 vakanca të përkohshme), në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar ndaj saj; 3) për shkak të mbarimit të statusit të magjistratit për gjyqtarët që kanë dhënë dorëheqjen ose pension të parakohshëm - z. {...}, znj. {...}, z. {...}, z. {...}, z. {...}, znj. {...}, z. {...}, z. {...}, znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}. Gjithsesi, në rast të ndryshimit të rrethanave që kushtëzuan transferimin, ndryshimit pozitivisht të situatës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë ose përkeqësimit të saj në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor

Fier/Berat/Dibër/Tropojë/Lushnjë, sipas rregullimit të kësaj pike të projektvendimeve, Këshilli mund të ndërpresë transferimin e përkohshëm të gjyqtarëve të përmendur më lart në propozimet e bëra nga ana e Komisionit.

Në pikën 2 të projektvendimit përcaktohet fillimi i efekteve juridike të vendimit të transferimit të përkohshëm, ku data mbetet të përcaktohet nga Këshilli në momentin e shqyrtimit të projektvendimit, duke konsideruar në këtë rast dhënien e efekteve në një datë të mëvonshme, deri 7 ditë (në qoftë se data sot është 6, ne propozojmë datën 13 dhe është një propozim që po e bëj unë në vijim të prezantimit të këtij relacioni), kjo me qëllim për të realizuar njoftimin e vendimit, si dhe për t'i dhënë kohën e nevojshme gjyqtarëve të transferuar për të kryer veprimet procedurale dhe administrative për dorëzimin e dosjeve të çështjeve gjyqësore që nuk do të vijojnë të gjykojnë prej tij. Vlen të përmendet se përcaktimi në këtë mënyrë i fillimit të efekteve të transferimit të përkohshëm nuk krijon asnjë problematikë në dhënien e drejtësisë për çështjet që gjyqtari z. {...}/ znj. {...}/ znj. {...}/ z. {...}/ znj. {...}/ znj. {...} ka për gjykim në gjykatat respektive, referuar asaj çka propozohet në pikën 4 të projektvendimit, ndërkohë që plotëson në një kohë sa më të shpejtë nevojat e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Në pikën 3 të projektvendimit urdhërohet përjashtimi menjëherë i gjyqtarit z. {...}/ znj. {...}/ znj. {...}/ z. {...}/ znj. {...}/ znj. {...} nga procedurat e ndarjes së çështjeve gjyqësore në gjykatat respektive, ndërsa ai me fillimin e transferimit të përkohshëm do të ngarkohet për gjykimin e çështjeve gjyqësore në gjykatën ku transferohet, pra në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Në pikën 4 të projektvendimit përcaktohet se gjyqtar z. {...}/ znj. {...}/ znj. {...}/ z. {...}/ znj. {...}/ znj. {...} ngarkohet të përfundojë të gjitha çështjet civile që kanë kaluar në seancë gjyqësore dhe çështjet penale të cilat janë në fazën e konkluzioneve përfundimtare si në seancë paraprake, ashtu edhe seancë gjyqësore, si dhe ato në çdo gjykatë tjetër i caktuar me vendim nga Këshilli i Lartë Gjyqësor. Ndërsa për çështjet e tjera gjyqësore në gjykatat respektive, në këtë pikë të projektvendimit, përcaktohet se dorëzohen menjëherë prej tyre. Rregulli sipas kësaj pike synon të shmangë dëmtimin e dhënies së drejtësisë në çështjet që gjyqtari që propozohet të transferohet ka për gjykim në gjykatat respektive, për të cilat ka filluar shqyrtimi gjyqësor. Në këtë rast është mbajtur në konsideratë edhe shmangia e caktimit të gjyqtarëve nga gjykata të tjera,

duke pasur parasysh për këtë numrin e kufizuar të gjyqtarëve të kësaj gjykate, çka mund të impononte një situatë të tillë.

Në pikën 5 të projektvendimit përcaktohet se efektet financiare sipas këtij vendimi përballohen nga (e kemi lënë alternative) Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier/ Berat/ Dibër/ Tropojë/ Lushnjë/ Tiranë (jemi të hapur për ta vendosur bashkërisht, pra ose Tirana ose gjykata nga ku ata kanë caktimin e përhershëm). Është për t'u diskutuar.

Në pikën 6 të projektvendimit përcaktohet se një kopje e këtij vendimi i njoftohet gjyqtarit të transferuar për kohësisht z. {...}/ znj. {...}/ znj. {...}/ z. {...}/ znj. {...}/ znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier/ Berat/ Dibër/ Tropojë/ Lushnjë dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Së fundi, në projektvendim përcaktohet dhe hyrja në fuqi e tij menjëherë dhe botimi në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Kurushi!

Ftoj anëtarët e Këshillit prezent në mbledhje nëse kanë diskutime për çfarë u parashtrua.

Po, zonja Ukperaj!

Brikena Ukperaj: Faleminderit zoti Zëvendëskryetar!

Atëherë, unë bie dakord me analizën që zoti Kurushi prezantoi sot para anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, dhe me funksionalitetin, por kamë një këndvështrim ndryshe për sa i përket një gjykate, që është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë.

Në fakt, edhe pse në relacion përmendet që një nga arsyet ose analiza bazohet edhe në fazën e implementimit të hartës gjyqësore, në mënyrë të detajuar më tepër është ndalur në funksionalitetin e gjykatave deri në datën 1 maj sesa në funksionalitetin e gjykatave pas datës 1 maj. Pse e them këtë? E them këtë për arsye sepse marrim në analizë Gjykatën e Kurbinit dhe Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë. Gjykata e Kurbinit dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, mbas datës 1 maj do të funksionojnë si gjykata e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Lezhë, çka do të thotë që çështjet e

këtyre dy gjykatave do të bashkohen dhe do të gjykohen në gjykatën e juridiksionit të përgjithshëm Lezhë. Ndërkohë që Gjykata e Kurbinut nuk përjashtohet nga gjykatat që i cenohet funksionaliteti, pra përfshihet tek gjykatat që nuk i cenohet funksionaliteti dhe Lezha përfshihet tek gjykatat që i cenohet funksionaliteti. Më duket trajtim i diferencuar, sepse e vetmja arsye mbi të cilën bazohet propozimi mbi Lezhën është fakti që dëmtohet gjykimi i çështjeve nga një trup gjykues i përbërë nga tre gjyqtarë. E njëjta gjë do të ndodhë edhe me Kurbinin, sepse nëse gjyqtari {...} del në pension dhe një nga gjyqtarët e Kurbinut është propozuar për transferim në Durrës, përsëri dy gjyqtarë do të mbeten edhe aty, pra edhe aty do të cenohet funksionaliteti për sa i përket të gjykuarit me tre gjyqtarë.

Jo vetëm kjo. Marrim Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnje. Jam dakord me arsyetimin e bërë nga zoti Kurushi dhe nga Komisioni në relacion, që gjykata e Lushnjës bashkohet me gjykatën e Fierit, mbas datës 1 maj, dhe për shkak të numrit të gjyqtarëve dhe volumit të çështjeve mund të shkojmë që nga kjo gjykatë e bashkuar të marrim edhe deri në tre gjyqtarë (se deri në tre gjyqtarë po marrim, po marrim 2 nga Fieri dhe 1 nga Lushnja). Po Lushnjës nuk i dëmtohet funksionaliteti në rastin kur ikën një gjyqtar dhe mbeten dy për të gjykuar me trup gjykues deri në datën 30 prill? Pra i dëmtohet. Nëse do të mbajmë këtë standard, o duhet t'i përjashtojmë të gjitha, o duhet t'i përfshijmë të gjitha.

Në vlerësimin tim, duke marrë parasysh funksionalitetin në një këndvështrim afatgjatë, pra jo për dy muaj, por për një vit, harta do fillojë funksionimin e saj më datë 1 maj, mendoj që në listën e gjykatave që nuk dëmtohet funksionaliteti, të përfshihet edhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe të konsiderohet Gjykata e Kurbinut dhe Gjykata e Lezhës si një gjykatë e vetme kur bëhet fjalë për transferim gjyqtari, jo dy gjykata të ndryshme. Pra propozimi im është që në rrethin e gjykatave që nuk dëmtohet funksionaliteti, të përfshihet edhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë. Pastaj propozimet i kam pasi Këshilli ta miratojë ose jo këtë propozimin tim. Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Ukperaj!

Ka ndonjë koment apo diskutim për çfarë u parashtrua nga zonja Ukperaj?

Po, zoti Kurushi!

Klodian Kurushi: Faleminderit zoti Zëvendëskryetar!

Në lidhje me këtë propozim unë kam një koment. Po të shikojmë faqen 40, pika 11.1.8.1 të relacionit, ne kemi marrë në analizë efektivitetin dhe funksionalitetin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, jo vetëm në aspektin e para hartës (siç u parashtrua), por edhe pas hartës, pas bashkimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin. Dhe çfarë na rezulton në këtë analizë? Është një gjykatë e cila nuk i referohemi vetëm numrit 3 të gjyqtarëve, por edhe ngarkesës që është relativisht e lartë me të gjitha gjykatat e tjera. Përpara hartës kemi një ngarkesë prej 289 çështjesh për gjyqtar dhe pas hartës kemi një ngarkesë prej 283 çështjesh për gjyqtar. Në krahasim me të gjitha gjykatat e tjera që i përmenda, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë ka ngarkesë më të madhe. Dhe kjo është arsyeja, për funksionalitet, për shkak të ngarkesës mesatare të gjyqtarëve, ne e kemi përjashtuar Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë nga numri i gjykatave nga ku do të bëhet edhe përzgjedhja e gjyqtarëve. Faleminderit!

Brikena Ukperaj: Për të bërë edhe unë analizën matematikore.

Në fakt, tek pika 7 thuhet: Ngarkesa e saj aktualisht është 850 çështje, pra Gjykata e Lezhës sot ka 850 çështje. Në qoftë se do të marrim këtë numër çështjesh ta bashkojmë me gjykatën e Kurbinin e cila sot ka 308 çështje, shkojmë në një llogaritje 1158 çështje. Në qoftë se këtë numër ne e pjesëtojmë (pra marrim nga gjykata e Kurbinin dhe Lezhës 1 gjyqtar) dhe e pjesëtojmë, na mbeten 2 gjyqtarë në Lezhë dhe shkojnë 3 gjyqtarë nga Kurbinin, ngarkesa mesatare për gjyqtar është 200 çështje, aq sa shkon edhe në Fier dhe në gjykatat e tjera.

Klodian Kurushi: Kam përshtypjen se kemi prapë një problem.

Ne thamë që 2 gjyqtarë potencialisht nga Kurbinin lëvizin sepse njëri del në pension dhe gjyqtari tjetër shkon potencialisht në propozimin tonë në Durrës.

Brikena Ukperaj: Po pra unë Durrësin do ta shikoj në një moment të dytë. Pse duhet të shkojë gjyqtari i Kurbinin në Durrës, kur kemi gjykatën e Lezhës, të marrim një gjyqtar të Lezhës e çojmë në Tiranë dhe... është e njëjta gjë. Ne diskutojmë njëherë këtu dhe pastaj shkojmë tek Durrësi.

Klodian Kurushi: Të dyja propozimet ne i kemi bërë në të njëjtën kohë, edhe Tiranën edhe Durrësin, nuk i kemi marrë veç e veç. Kemi marrë Tiranën dhe Durrësin bashkërisht, sepse janë të dyja gjykata në nevojë. E kemi filluar si radhë me Tiranën dhe kemi parashikuar edhe Durrësin. Domethënë kemi marrë dy gjyqtarët që mund të lëvizin edhe për Tiranën edhe për Durrësin. E në këtë pikë ne kemi dalë në këtë konkluzion duke i marrë të dyja bashkë, edhe njërin edhe tjetrin.

Brikena Ukperaj: Dakord.

Klodian Kurushi: Kështu që nuk e kemi ndarë veç njërin dhe pastaj veç tjetrin. Kjo është arsyeja pse ne na del mesatarja e çështjeve me 283 çështje për gjyqtar.

Brikena Ukperaj: Atëherë, duke qenë se ne po diskutojmë fillimisht Tiranën, pa kaluar tek Durrësi, sepse mund të kemi propozime të tjera, marrim numrin aktual të gjyqtarëve të Kurbinit dhe të Lezhës që bashkohen në Lezhë, dhe kemi mundësi që një gjyqtar nga kjo gjykatë e bashkuar të transferohet, dhe ky të jetë gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, edhe për një fakt tjetër, sepse është gjyqtari që ka 15 vjet dhe 7 muaj në detyrë dhe nuk është gjyqtar që ka 3 vjet në detyrë. Edhe për faktin tjetër, që Tirana kërkon gjyqtarë që kanë një përvojë profesionale të tillë sepse ka çështje më komplekse, prandaj dhe e kemi parashikuar këtë gjë. Prandaj propozimi im është që të përfshihet Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë në gjykata që nuk dëmtohet funksionaliteti.

Ilir Rusi: Po, zoti Kurushi!

Klodian Kurushi: Faleminderit!

Nëse do të shikoni edhe pjesën e përvojës, meqenëse na u vendos edhe përvoja si kriter, do të shikoni që të gjithë gjyqtarët e propozuar nga ana jonë, për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, kanë përvojë mesatarisht mbi 7, 8, 9 vjet. Mund të ketë ndonjë përjashtim, por në përgjithësi të gjithë gjyqtarët kanë përvojë të lartë profesionale në prezantimin që kemi bërë ne për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Prandaj edhe

30

kriterin e përvojës profesionale, ne e kemi marrë në konsideratë kur kemi bërë propozimet {...} për të bërë transferimin e përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Kurushi!

Ka diskutime të tjera nga anëtarët?

Atëherë, meqenëse nuk ka diskutime...? Keni diskutime të tjera zonja Ukperaj?

Brikena Ukperaj: Mund ta formuloj propozimin?

Ilir Rusi: Atë do thosha. Meqë nuk ka diskutime, dua ta perifrazoni propozimin tuaj, me qëllim që ta hedh në votim.

Brikena Ukperaj: Atëherë, unë vlerësoj që Këshilli paraprakisht duhet të votojë për listën e gjykatave që nuk i dëmtohet funksionaliteti dhe në këndvështrimin e zbatimit të hartës së re gjyqësore, ngarkesës së gjyqtarëve, dobishmërisë që sjell transferimi për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, dhe pritshmërive që ekzistojnë në ngarkesat e gjyqtarëve pas implementimit të hartës gjyqësore, do të propozoja që në listën e gjykatave të përfshihet edhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë sepse ka të njëjtat standarde, si Kurbini, si Lushnja, që janë përfshirë në listë.

Ilir Rusi: Mirë atëherë, vazhdojmë në votimin e propozimit të zonjës Ukperaj.

Irena Plaku: Pro. Në marrjen e këtij vendimi kam parasysh edhe përvojën profesionale të lartë të gjyqtarit që përfshihet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë. Për mendimin tim duhet të përfshihen gjykata e Kurbinit dhe e Lezhës si një e vetme, dhe duke qenë si një e vetme mund të marrim vetëm një gjyqtar, duke pasur parasysh funksionalitetin e saj. Jam dakord me propozimin.

Dritan Hallunaj: Kundër.

Ridvan Hado: Kundër.

Alban Toro: Kundër, për shkak se bie në kundërshtim edhe me nenin 4, pika 5 të Rregullores “Për transferimin e përkohshëm”. Aktualisht ajo që shfaqet apo panorama

e përgjithshme e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë ka një ngarkesë të jashtëzakonshme, që është 850 çështje, kështu që në këtë kontekst ajo bie në kundërshtim me momentin aktual ku po ndodh transferimi. Se çdo të ndodhë nesër me hartën gjyqësore, nuk e dimë, do të jetë problem tjetër, të cilin do ta diskutojmë/do ta rregullojmë nëse do të ketë probleme të tipit organizativ.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Kundër.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Kundër.

Ilir Rusi: Kundër.

Rrëzohet propozimi i zonjës Ukperaj.

Vazhdojmë me diskutimet e mëtejshme.

Atëherë zoti Kurushi, meqenëse propozimi i zonjës Ukperaj ra, si je në vijueshmëri?

Brikena Ukperaj: Kam një diskutim akoma.

Ilir Rusi: Po, zonja Ukperaj!

Brikena Ukperaj: Atëherë, referuar Rregullores për transferimin, kemi dy gjykata që janë në funksionalitet dhe nuk dëmtohet funksionaliteti, këto janë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë. Gjykata më e afërt është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë. Prandaj propozoj që gjyqtari që duhet të transferohet nuk duhet të jetë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë, por duhet të jetë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë (në zbatim të rregullores).

Klodian Kurushi: Ta jap edhe një përgjigje për këtë pjesën?

Faleminderit zoti Zëvendëskryetar!

U propozua që të krahasohet Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë. Dakord, në këtë pikë edhe ne kemi bërë analizën e Gjykatës

së Rrethit Gjyqësor Korçë dhe Tropojë. Korçën e kemi përfshirë, nëse do ta shikoni, e kemi përfshirë në rrethin e gjykatave nga ku mund të përzgjedhim gjyqtarë. Megjithatë, nëse do të bëjmë krahasimin e gjykatave dhe të ngarkesës në punë të gjykatave të rrethit gjyqësor Tropojë dh Korçë, rezulton që ngarkesa është disproporcionale. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë ka një numër relativisht të ulët të çështjeve që gjykohen nga gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, rreth 77 çështje. Ndërsa Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë është një gjykatë që ka një nivel shumë të lartë mesatarisht dosjesh, që gjykohen nga gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë. Për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë, mbajmë parasysh edhe disa rrethana të tjera, që i përmendëm, siç është caktimi i gjyqtarëve në gjykata të tjera ku ata nuk ushtrojnë funksionin e përhershëm në gjykata, konkretisht përmend Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec, nga ku në projektion ne mund të na rezultojë që edhe një gjyqtar i kësaj gjykate mund të shkojë në një lëvizje paralele. Kështu që, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, duke u bashkuar me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec, duke i ikur edhe një gjyqtar në projektionin tonë, ngarkesa do t'i shtohet. Ndërkohë që, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë në këtë rast ka një numër relativisht të ulët edhe në projektimin e bashkimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës, përsëri, numri mesatar i çështjeve për gjyqtar do të jetë shumë herë më i vogël sesa numri mesatar i çështjeve që do të ketë në gjykim në ngarkim Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë. Kjo është arsyeja pse ndërmjet këtyre dy gjykatave, ne kemi propozuar të përzgjedhim Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë për të marrë gjyqtarin dhe për ta sjellë me transferim të përkohshëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Faleminderit!

Brikena Ukperaj: Jam dakord. Jam e qartë në bazë të argumentimit të zotit Kurushi dhe heq dorë nga propozimi.

Ilir Rusi: Atëherë, ka diskutime të tjera?

Atëherë, meqenëse nuk ka diskutime, hedhim në votim propozimet e bëra nga KZHK-ja të cilat për shkak të diskutimeve dhe të votimit, do kërkoja edhe një herë perifrazimin në mënyrë shumë sintetike, nga relatori përkatës, në lidhje me projektvendimet për t'u hedhur në votim, duke u përcaktuar edhe datat përkatëse.

33

Klodian Kurushi: Faleminderit zoti Zëvendëskryetar!

Në lidhje me projektvendimet. Po filloj me projektvendimin e parë sipas rendit që është transferimi i përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, të gjyqtarit z. {...}.

Në këtë projektvendim ne bëmë dy propozime, njërin thamë datën 13 si datë kur mund të fillojnë efektet juridike të transferimit të përkohshëm, pra 13.03; ndërsa për efektet financiare të këtij vendimi ne i kemi lënë opsionale. Neve mendojmë që mund të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ajo që do të ishte më mirë të përballonte efektet financiare të transferimit të përkohshëm, por kjo është opsionale. Propozimi ynë si Komision është që efektet financiare të këtij vendimi të përballohen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, dhe për të vijuar më tej të gjithë projektvendimin:

Transferimin e përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë në një pozicion të përkohshëm në fushën e së të drejtës civile të gjyqtarit z. {...}, për një periudhë deri në një vit, që mund të ndërpritet në rast të ndryshimit të rrethanave që kushtëzuan transferimin.

2. Efektet juridike të transferimit të përkohshëm fillojnë më datë 13.03.2023.

3. Gjyqtari {...} përjashtohet menjëherë nga procedurat e ndarjes së çështjeve gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier.

4. Gjyqtari {...} ngarkohet të përfundojë të gjitha çështjet civile që kanë kaluar në seancë gjyqësore dhe çështjet penale të cilat janë në fazën e konkluzioneve përfundimtare si në seancë paraprake, ashtu edhe në seancë gjyqësore, si dhe ato në çdo gjykatë tjetër i caktuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor. Çështjet e tjera gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier dorëzohen menjëherë prej tij.

5. Efektet financiare të këtij vendimi përballohen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë (propozim i Komisionit).

6. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarit të transferuar përkohësisht z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Këto janë propozimet {...} për projektvendimin e parë që i referohet gjyqtarit z. {...}. Faleminderit!

Ilir Rusi: A ka qëndrime të tjera në lidhje me propozimet e bëra së fundi nga zoti Kurushi në lidhje me projekt-aktin përkatës?

(Nuk ka.)

Atëherë, vazhdojmë me hedhjen në votim të projekt-aktit përkatës në lidhje me magjistratin, z. {...}.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për transferimin e përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, të gjyqtarit z. {...}”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse vendosi:

1. Transferimin e përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë në një pozicion të përkohshëm në fushën e së të drejtës civile të gjyqtarit z. {...}, për një periudhë deri në një vit, që mund të ndërpritet në rast të ndryshimit të rrethanave që kushtëzuan transferimin.

2. Efektet juridike të transferimit të përkohshëm fillojnë më datë 13.03.2023.

3. Gjyqtari {...} përjashtohet menjëherë nga procedurat e ndarjes së çështjeve gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier.

4. Gjyqtari {...} ngarkohet të përfundojë të gjitha çështjet civile që kanë kaluar në seancë gjyqësore dhe çështjet penale të cilat janë në fazën e konkluzioneve përfundimtare si në seancë paraprake, ashtu edhe në seancë gjyqësore, si dhe ato në çdo gjykatë tjetër i caktuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor. Çështjet e tjera gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier dorëzohen menjëherë prej tij.

5. Efektet financiare sipas këtij vendimi përballohen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

6. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarit të transferuar përkohësisht z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ilir Rusi: Për më tej vazhdojmë nëse keni propozime konkrete në lidhje me... Atëherë, meqenëse mund të jetë e njëjta, mund t’i perifrasoni në mënyrë të përmbledhur për të gjitha aktet përkatëse.

Klodian Kurushi: Faleminderit zoti Zëvendëskryetar!

Atëherë, siç propozuam ndryshimet e fundit ose shtesat e fundit për projektvendimin që i referohet transferimit të përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë të zotit {...}, propozojmë të njëjtat plotësime që duhet t’i bëhen të gjithë projektvendimeve përkatëse që i referohen transferimit të përkohshëm me pëlqim të gjyqtarëve znj. {...}, znj. {...}, z. {...}, znj. {...}, znj. {...}. Propozimet janë që efektet juridike të transferimit të përkohshëm fillojnë më datë 13.03.2023, si dhe propozimi i radhës i referohet pikës 5 të projektvendimit, që efektet financiare sipas këtij vendimi përballohen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Këto janë propozimet për të gjithë projektvendimet e tjera të radhës.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Ka diskutime për çfarë u parashtrua nga zoti Kurushi?

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me hedhjen në votim të projektvendimit në lidhje me magjistraten znj. {...}.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për transferimin e përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, të gjyqtares znj. {...}”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse vendosi:

1. Transferimin e përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë në një pozicion të përkohshëm në fushën e së të drejtës civile të gjyqtares znj. {...}, për një periudhë deri në një vit, që mund të ndërpritet në rast të ndryshimit të rrethanave që kushtëzuan transferimin.

2. Efektet juridike të transferimit të përkohshëm fillojnë më datë 13.03.2023.

3. Gjyqtarja {...} përjashtohet menjëherë nga procedurat e ndarjes së çështjeve gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier.

4. Gjyqtarja {...} ngarkohet të përfundojë të gjitha çështjet civile që kanë kaluar në seancë gjyqësore dhe çështjet penale të cilat janë në fazën e konkluzioneve përfundimtare si në seancë paraprake, ashtu edhe në seancë gjyqësore, si dhe ato në çdo gjykatë tjetër e caktuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor. Çështjet e tjera gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier dorëzohen menjëherë prej saj.

5. Efektet financiare sipas këtij vendimi përballohen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

6. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtares së transferuar përkohësisht znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të

drejtësisë”, i ndryshuar, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ilir Rusi: Vazhdojmë me hedhjen në votim të projektvendimit për magistraten znj. {...}.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për transferimin e përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, të gjyqtares znj. {...}”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse vendosi:

1. Transferimin e përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë në një pozicion të përkohshëm në fushën e së të drejtës civile të gjyqtares znj. {...}, për një periudhë deri në një vit, që mund të ndërpritet në rast të ndryshimit të rrethanave që kushtëzuan transferimin.

2. Efektet juridike të transferimit të përkohshëm fillojnë më datë 13.03.2023.

3. Gjyqtarja {...} përjashtohet menjëherë nga procedurat e ndarjes së çështjeve gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat.

4. Gjyqtarja {...} ngarkohet të përfundojë të gjitha çështjet civile që kanë kaluar në seancë gjyqësore dhe çështjet penale të cilat janë në fazën e konkluzioneve përfundimtare si në seancë paraprake, ashtu edhe në seancë gjyqësore, si dhe ato në çdo

gjykatë tjetër e caktuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor. Çështjet e tjera gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat dorëzohen menjëherë prej saj.

5. Efektet financiare sipas këtij vendimi përballohen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

6. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarës së transferuar përkohësisht znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ilir Rusi: Nëse nuk ka diskutime mbi propozimin në lidhje me projektvendimin për sa i përket magjistratit z. {...}, vazhdojmë hedhjen në votim të tij.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për transferimin e përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, të gjyqtarit z. {...}”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse vendosi:

1. Transferimin e përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë në një pozicion të përkohshëm në fushën e së të drejtës civile të gjyqtarit z. {...}, për një periudhë deri në një vit, që mund të ndërpritet në rast të ndryshimit të rrethanave që kushtëzuan transferimin.

2. Efektet juridike të transferimit të përkohshëm fillojnë më datë 13.03.2023.

3. Gjyqtari {...} përjashtohet menjëherë nga procedurat e ndarjes së çështjeve gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër.

4. Gjyqtari {...} ngarkohet të përfundojë të gjitha çështjet civile që kanë kaluar në seancë gjyqësore dhe çështjet penale të cilat janë në fazën e konkluzioneve përfundimtare si në seancë paraprake, ashtu edhe në seancë gjyqësore, si dhe ato në çdo gjykatë tjetër i caktuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor. Çështjet e tjera gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër dorëzohen menjëherë prej tij.

5. Efektet financiare sipas këtij vendimi përballohen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

6. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarit të transferuar përkohësisht z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ilir Rusi: Nëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me hedhjen në votim të projektvendimit në lidhje me magjistraten zonjën {...}.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për transferimin e përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, të gjyqtares znj. {...}”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse vendosi:

1. Transferimin e përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë në një pozicion të përkohshëm në fushën e së të drejtës civile të gjyqtares znj. {...}, për një periudhë deri në një vit, që mund të ndërpritet në rast të ndryshimit të rrethanave që kushtëzuan transferimin.

2. Efektet juridike të transferimit të përkohshëm fillojnë më datë 13.03.2023.

3. Gjyqtarja {...} përjashtohet menjëherë nga procedurat e ndarjes së çështjeve gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë.

4. Gjyqtarja {...} ngarkohet të përfundojë të gjitha çështjet civile që kanë kaluar në seancë gjyqësore dhe çështjet penale të cilat janë në fazën e konkluzioneve përfundimtare si në seancë paraprake, ashtu edhe në seancë gjyqësore, si dhe ato në çdo gjykatë tjetër e caktuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor. Çështjet e tjera gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë dorëzohen menjëherë prej saj.

5. Efektet financiare sipas këtij vendimi përballohen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

6. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtares së transferuar përkohësisht znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ilir Rusi: Për më tej vazhdojmë me projektvendimin në lidhje me magjistraten znj. {...}. Nëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me hedhjen në votim të tij.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për transferimin e përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, të gjyqtarës znj. {...}”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse vendosi:

1. Transferimin e përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë në një pozicion të përkohshëm në fushën e së të drejtës civile të gjyqtarës znj. {...}, për një periudhë deri në një vit, që mund të ndërpritet në rast të ndryshimit të rrethanave që kushtëzuan transferimin.

2. Efektet juridike të transferimit të përkohshëm fillojnë më datë 13.03.2023.

3. Gjyqtarja {...} përjashtohet menjëherë nga procedurat e ndarjes së çështjeve gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

4. Gjyqtarja {...} ngarkohet të përfundojë të gjitha çështjet civile që kanë kaluar në seancë gjyqësore dhe çështjet penale të cilat janë në fazën e konkluzioneve përfundimtare si në seancë paraprake, ashtu edhe në seancë gjyqësore, si dhe ato në çdo gjykatë tjetër e caktuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor. Çështjet e tjera gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë dorëzohen menjëherë prej saj.

5. Efektet financiare sipas këtij vendimi përballohen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

6. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarës së transferuar përkohësisht znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 06.03.2023)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z.Klodian Kurushi).

2.1 Për transferimin e përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës të gjyqtarit z.{...};

2.2 Për transferimin e përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës të gjyqtarit z.{...}.

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 09:49 dhe mbaroi në orën 14:38.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|----------------------------------|---------------------------------|
| <i>1. Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>2. Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>3. Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>4. Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>5. Dritan Hallunaj</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>6. Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>7. Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>8. Marçela Shehu</i> | <i>(anëtare)</i> |

9. Brikena Ukperaj (anëtare)

10. Yllka Rupa (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

4. Valbona Bala, eksperte (EWMI-INL).

5. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

6. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.

7. Të tjerë: Paola Ndroqi (Universiteti “Epoka”), Edmond Hoxhaj (Birn).

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z.Klodian Kurushi).

2.1 Për transferimin e përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës të gjyqtarit z. {...};

2.2 Për transferimin e përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës të gjyqtarit z. {...}.

Ilir Rusi: Në vijim të mbledhjes, nëse do referoheshim rendit të ditës, duhet të kalonim në pikën dy të saj që është shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga KZHK-ja me relator z. Klodian Kurushi: Për transferimin e përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës të gjyqtarit z. {...} dhe nënpika 2 e saj është “Për transferimin e përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës të gjyqtarit z. {...}”, por meqenëse ora ka kaluar 11 dhe ne kohë më parë kemi lënë një seancë

dëgjimore për zotin {...}, do t'i kërkoja administratës që është pjesë mbështetëse e mbledhjes, për të na azhurnuar në lidhje me prezencën e palëve në këtë seancë dëgjimore.

Po, zoti Dibra!

Luan Dibra: Komunikua me zotin {...}, na tha që është në poliklinikë për momentin, do sjellë raport tjetër mjekësor. Është në pritje të marrjes së raportit mjekësor. E njoftua që duhet ta përcjellë menjëherë, por deri tani, deri në orën 11:10, akoma nuk ka dërguar gjë.

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Dibra!

Ndonjë diskutim nga anëtarët?

Ridvan Hado: Si relator i çështjes ndaj magjistratit {...}, propozoj që të vazhdojmë me rendin e ditës, në kushtet kur ai ka njoftuar që gjendet në ambulancë për të ripërsëritur raportin mjekësor. Të vazhdojmë me rendin e ditës dhe të shikojmë në fund rezultatin nëse do paraqesë raportin mjekësor apo jo. Faleminderit!

Ilir Rusi: Ka diskutime të tjera nga anëtarët?

Meqenëse nuk ka diskutime, ne vijojmë me rendin e ditës, me pikën 2 të saj, duke ia dhënë fjalën për më tej relatorit z. Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit zoti Rusi!

Projektvendimet e radhës kanë për objekt transferimin e përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës. Bashkëlidhur projektvendimeve ne paraqesim dhe bëjmë prezantim të shpejtë të relacionit mbi transferimin e përkohshëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës sepse janë të njëjtat situata, të njëjtat rrethana, është e njëjta analizë, e njëjta metodologji e përdorur nga ana jonë, për të bërë përzgjedhjen përkatëse. Kështu që, nëse kolegët bien dakord, kalojmë në fazën e konkluzioneve, se janë të njëjtat... Nëse bini të gjithë dakord.

Atëherë, Komisioni mbi këtë bazë ka përgatitur dhe i ka propozuar Këshillit

projektvendimin “Për transferimin e përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, të gjyqtarit z. {...}”.

Vijojmë me gjykatën e dytë ku ne bëjmë përzgjedhjen midis kandidatëve që janë zonja {...}, zoti {...} dhe zoti {...}, që plotësojnë të njëjtat kriteri nën ndikimin e transferimit dhe ngarkesës. Për të identifikuar mes tyre gjyqtarin që duhet të transferohet përkohësisht në rastin konkret, u konsiderua masa e përvojës profesionale.

Mbajtur në konsideratë përcaktimin e pikës 5 të nenit 4 të rregullores: “...Në rast se kandidatët vijnë nga e njëjta gjykatë, Këshilli përzgjedh kandidatin duke marrë në konsideratë përvojën profesionale të gjyqtarëve dhe fushën e së drejtës për të cilën kërkohet shërbimi i tij.”, rezulton se zonja {...} dhe z. {...} kanë përvojë 3 vite, ndërsa për z. {...} ka përvojë 2 vite.

Mbi sa më lart, referuar kriterit të përzgjedhjes së “përvojës profesionale në fushën e së drejtës për të cilën kërkohet shërbimi”, gjyqtari që duhet të transferohet në Durrës, sipas mendimit tonë, është z. {...}.

Mbi këtë bazë Komisioni ka përgatitur dhe i propozon Këshillit projektvendimin “Për transferimin e përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, të gjyqtarit z. {...}”.

Struktura e projektvendimit (*janë dy projektvendime*):

Projektvendimet e mësipërme janë strukturuar në 6 pika

Në pikën e parë të projektvendimit propozohet transferimi i përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës të gjyqtarit z. {...}/ z. {...}, për një periudhë deri në një vit, që mund të ndërpritet në rast të ndryshimit të rrethanave që kushtëzuan transferimin. Periudha e transferimit është propozuar një vit, pra në afatin maksimal sipas pikës 6, të nenit 46, të Ligjit për Statusin, duke u mbajtur në konsideratë situata në të cilën gjendet aktualisht gjykata në nevojë, pra Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, situatë e cila pritet të jetë e tillë edhe në vijim, ndërsa vakancat në këtë gjykatë janë krijuar: 1) për shkak të mosplotësisht të vakancave të përhershme; 2) për shkak të pezullimit nga detyra të gjyqtarëve, si rezultat i shkarkimit nga detyra me vendim të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar ndaj saj, apo për shkak të procedimit penal; Gjithsesi, në rast të ndryshimit të rrethanave që kushtëzuan transferimin, ndryshimit pozitivisht të situatës në Gjykatën e Rrethit

Gjyqësor Durrës ose përkeqësimit të saj në Gjykatën e rrethit gjyqësor Kurbin/Sarandë, sipas rregullimit të kësaj pike të projektvendimeve, Këshilli mund të ndërpresë transferimin e përkohshëm të gjyqtarëve {...}/ {...} përpara afatit 1-vjeçar.

Në pikën 2 të projektvendimit përcaktohet fillimi i efekteve juridike të vendimit të transferimit të përkohshëm, ku data mbetet të përcaktohet nga Këshilli në momentin e shqyrtimit të projektvendimit.

Në pikën 3 të projektvendimit urdhërohet përjashtimi menjëherë i z. {...}/ z. {...} nga procedurat e ndarjes së çështjeve gjyqësore në gjykatat respektive, ndërsa ai me fillimin e transferimit të përkohshëm do të ngarkohet për gjykimin e çështjeve gjyqësore në gjykatën ku transferohet, pra në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës.

Në pikën 4 të projektvendimit përcaktohet se gjyqtari z. {...}/ z. {...} ngarkohet të përfundojë të gjitha çështjet civile që kanë kaluar në seancë gjyqësore dhe çështjet penale të cilat janë në fazën e konkluzioneve përfundimtare si në seancë paraprake, ashtu edhe seancë gjyqësore, si dhe ato në çdo gjykatë tjetër i caktuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor. Ndërsa për çështjet e tjera gjyqësore në gjykatat respektive, në këtë pikë të projektvendimit, përcaktohet se dorëzohen menjëherë prej tyre. Rregulli sipas kësaj pike synon të shmang dëmtimin e dhënies së drejtësisë në çështjet që gjyqtari që propozohet të transferohet ka për gjykim në gjykatat respektive, për të cilat ka filluar shqyrtimi gjyqësor. Në këtë rast është mbajtur në konsideratë edhe shmangia e caktimit të gjyqtarëve nga gjykata të tjera, duke pasur parasysh për këtë numrin e kufizuar të gjyqtarëve të kësaj gjykate, çka mund të impononte një situatë të tillë.

Në pikën 5 të projektvendimit përcaktohet se efektet financiare sipas këtij vendimi përballohen nga gjykatat..., (është lënë në alternativë, por duke u ndjekur ai rregull që u mbajt në vendimet e mëparshme, propozohet që efektet financiare të përballohen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës) pra nga gjykata ku gjyqtari transferohet përkohësisht.

Në pikën 6 të projektvendimit përcaktohet se një kopje e këtij vendimi i njoftohet gjyqtarit të transferuar përkohësisht z. {...}/ z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Gjykatës së rrethit gjyqësor Kurbin/Sarandë dhe Gjykatës së rrethit gjyqësor Durrës.

Së fundi, në projektvendim përcaktohet dhe hyrja në fuqi e tij që është menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Propozojmë edhe një herë datën 13. Pra është i njëjti propozim siç bëmë për projektvendimet e mëparshme. Faleminderit!

Ilir Rusi: Ka diskutime nga anëtarët prezent?

Po, zonja Ukperaj!

Brikena Ukperaj: Kam dy diskutime në fakt.

Diskutimi im i parë është për përzgjedhjen e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin si gjykata nga e cila ne duhet të transferojmë një gjyqtar.

Në vlerësimin tim, në grupin e gjykatave, dy gjykata të diskutueshme, duke qenë se Saranda është propozuar dhe jam dakord që nuk dëmton funksionalitetin, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin, kemi dhe Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë. Në qoftë se i krahasojmë këto të dy gjykata, Gjykata e Kurbin, mbas hartës gjyqësore bashkohet me Lezhën dhe nëse çështjet e Kurbin shkojnë në Lezhë, ngarkesa mesatare për gjyqtar do të jetë shumë herë më e madhe sesa ngarkesa mesatare e gjyqtarit në Korçë, e cila bashkohet me Pogradecin, e para.

E dyta, në këtë periudhë dymujore Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin ka dëmtim të funksionalitetit edhe pse mund të ketë numër më të vogël çështjesh, më të madh, sepse vetëm dy gjyqtarë do mbeten. Duke përdorur të njëjtin arsyetim që zoti Kurushi përdori kur përzgjodhi Gjykatën e Tropojës nga ajo e Korçës, pavarësisht se Gjykata e Kurbin është më afër Tiranës, unë propozoj që gjyqtari që duhet të përzgjidhet duhet të jetë nga Korça dhe jo nga Kurbin (siç ka qenë edhe propozimi i parë për {...}).

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Ukperaj!

Ka diskutime të tjera?

Klodian Kurushi: Atëherë, faleminderit zoti Zëvendëskryetar!

Sqarojmë edhe këtë pjesën tjetër në lidhje me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin është një gjykatë që ka një distancë

gjeografike shumë të afërt me Durrësin në raport me të gjithë gjykatat e tjera. Është një vendim i mbajtur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor për distancat, e para. E dyta, aktualisht, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin ka numrin më të pakët të çështjeve në raport me të gjitha gjykatat e tjera (është 77 çështje). E treta, në hipotezën që Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin do bashkohet me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë, numri mesatar i çështjeve është e vërtetë që mund të rritet. Është i rritur...

Në raport me Korçën? Në lidhje me Korçën mund t'ju them diçka tjetër.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, në hipotezën e një të afërmje jo të afërt sepse në shifra, Kurbin me Korçën janë shumë larg nga njëri-tjetri. Numri mesatar i çështjeve në Kurbin është më i ulët, shumë herë më i ulët se sa numri mesatar i çështjeve në Gjykatën e Korçës.

Tani do flasim me hartën, në lidhje me të folurin me hartë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë bashkohet me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec dhe nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec aktualisht mund të shkojë vetëm një gjyqtar. Aktualisht janë dy.

Brikena Ukperaj: Kemi vendosur që do i ndërpresim transferimin në 1 maj. E kemi të vendosur.

Klodian Kurushi: Më lini ta diskutoj deri në fund. Më lini ta mbaroj. Unë ju dëgjova. Më dëgjoni edhe mua, pastaj do ju dëgjoj edhe unë prapë.

Aktualisht në bashkimin e datës 1, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë me bashkimin me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec bëhen të dyja me dy gjyqtarë. Potencialisht, njëri nga gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, potencialisht ka mundësi për t'u lëvizur me skemën e lëvizjes paralele në gjykatat e rretheve gjyqësore Tiranë dhe Durrës (është në proces konkurrimi) dhe ka mundësi...

Kush nuk ka ndalesë?

(Dikush nga anëtarët flet pa ndezur mikrofonin.)

Klodian Kurushi: A po flasim për hartën?

Po flasim për numrin e gjyqtarëve?

Po atëherë, nëse flasim për numrin e gjyqtarëve, do i marrim në konsideratë edhe këtë pjesë.

Tek të gjitha i kemi marrë. Nuk e ke pasur vëmendjen, se i kemi marrë tek të gjitha.

Jua thashë edhe më përpara, po jua them, kur lexova relacionin e mëparshëm, jua thashë ku mbështetet. E keni edhe të shkruar.

Duke marrë në konsideratë edhe këtë pjesën tjetër që ju thashë, potencialisht një kandidat ka mundësi të lëvizti paralelisht, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec mund të shkojë një ose dy gjyqtarë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë. Kështu që, në këtë situatë, përsëri ne mendojmë që ndodhet në një pozicion (në llogaritjet tona) më të mirë bashkimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbini me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë, për të bërë transferimin e një gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës. Kemi marrë në konsideratë edhe këto rrethana që unë i përmenda dhe kjo është arsyeja pse në propozimet tona ne themi që dy nga kandidatët e përmendur më lart janë kandidatë që nuk sjellin dëme, efekte negative më të mëdha sesa po t'i krahasojmë me gjykatat e tjera në rastin e transferimit që atyre do t'u bëhet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës. Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Kurushi!

Po, zonja Plaku!

Irena Plaku: Atëherë, sipas relacionit të paraqitur, vlerësoj se gjykata që i prishet më pak funksionaliteti, në fakt është Gjykata e Korçës. Pse? Se në radhë të parë, Gjykatës së Kurbinit i prishet funksionaliteti (nuk do formohen trupat gjykues), ndërsa Korçës nuk i ndodh një gjë e tillë.

Sa i përket pretendimit që është marrë parasysh edhe lëvizja paralele, mendoj që kjo nuk ka asnjë ndikim, megjithatë po të shikojmë transferimet e miratuara tashmë me vendim, kemi z. {...} që ka shanse për lëvizje paralele, për ngritje në detyrë, sepse ka edhe dy vlerësime. Kemi {...}... Jo, jo, nuk po paragjykoj. Mundësinë them, mundësinë duke pasur dy vlerësime. {...} {...}n dhe {...}. Domethënë kemi pesë mundësi që të

50

pestë këta t'i bëjmë me lëvizje paralele, po bëhen kaq shpejt, me shpresën që do bëhen shpejt, që të kemi mundësi të emërojmë gjyqtarë të rinj, domethënë të hapim vendet për magistratët e rinj. Kështu që, diskutimi për lëvizjen paralele nuk besoj se është marrë aq shumë në konsideratë, për sa kohë që ne miratuar tashmë 5 gjyqtarë të cilët kanë mundësi potenciale për të ardhur në Tiranë me lëvizje paralele.

Atëherë, për sa i përket Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, aktualisht atje janë në detyrë dy gjyqtarë, ku njëri është me lëvizje të përkohshme në Kavajë, për të cilin keni parashikuar edhe një afat për mbarimin e transferimit të përkohshëm, që është 1 maji. Çka do të thotë që në 1 maj tre gjyqtarë do jenë në Korçë (domethënë do i bashkohen). Ndërsa, po të marrim Kurbinin, kemi tre në Lezhë aktualisht. Sa gjyqtarë kemi në Kurbin? Dy do shkojnë sepse siç keni thënë ju, në mars – ne jemi në muajin mars tani – {...} del në pension. Domethënë kur thuhet në mars të 2023, s'e di domethënë?! Në fakt ne kemi në muajin mars. Kështu që potencialisht shkojnë dy gjyqtarë. Potencialisht, në mars (se është shkruar në mars), në Lezhë bashkohen dy gjyqtarë (dy gjyqtarë nga Kurbinin), ndërsa në Korçë bashkohen tre gjyqtarë të tjerë, pa lëvizur tek lëvizja paralele sepse ndër të tjera nuk ka mbaruar asnjë procedurë, por siç e thamë kemi tashme praktikë që vetë Këshilli miratoi 5 kandidatë të mundshëm, të cilët kanë mundësi (të mundshëm thashë sepse për ngritjen në detyrë kanë konkurruar në të gjitha vendet. Po them, potencial që kanë nga dy vlerësime, janë 5 gjyqtarë të tjerë të cilët i miratuar. Nuk u konsiderua kjo që, meqë do i çojmë me lëvizje paralele, s'po i çojmë në lëvizje të përkohshme, nuk u mor fare parasysh kjo. Bile për mua do jetë shumë mirë...

Jo nuk është marrë se janë 5.

(Zoti Kurushi flet pa ndezur mikrofonin.)

Irena Plaku: Tani, unë po të them sa janë gjyqtarë, zoti Kurushi.

Unë e kam lexuar relacionin, pa merak për këtë pjesë.

E keni vënë në një nga pikat që është marrë parasysh por nuk e di se si është marrë parasysh, për t'i transferuar apo për t'i penguar për t'i transferuar. Pse? Sepse po të themi që është marrë parasysh për t'i transferuar, këtë e marrë plotësisht të mirëqenë,

sepse kemi sjellë 5. Për njëren, për shkak të mundësisë, nuk e morëm. Vetëm për njërin. Për pesë të tjerët po, e kemi bërë.

(Zoti Kurushi flet pa ndezur mikrofonin.)

Irena Plaku: Këshilli thashë unë. Nuk thashë “unë”. Nuk thashë “juve”.

(Zoti Kurushi flet pa ndezur mikrofonin.)

Irena Plaku: Këtë po them. Nuk e di se si i kemi marrë thashë, për t’i pranuar apo për t’i skualifikuar.

(Zoti Kurushi flet pa ndezur mikrofonin.)

Irena Plaku: Të njëjtën gjë duhet të veprojmë edhe në Korçë, edhe për t’i pranuar edhe për t’i skualifikuar. Të mos nisemi me emra gjyqtarësh, por të nisemi me gjykata, funksionalitetin, atë që ju thatë.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Plaku!

Po, zoti Toro!

Alban Toro: Atëherë, edhe në rastin konkret është ndjekur e njëjta metodologji, janë zbatuar të njëjtat parime, madje këtu përputhen akoma edhe më shumë distanca (bëhet fjalë midis marrjes së gjyqtarit në Kurbin apo Korçë), distanca dhe ajo që është më e rëndësishme është ngarkesa mesatare për gjykatë. Siç e shikojmë Korça ka 290 çështje për gjyqtar, ndërsa Kurbin 77. Vazhdojmë bisedojmë për të ardhmen, kur e ardhmja akoma s’ka ardhur, pavarësisht se duket e ndritur, por mos harroni që kemi edhe 40 kandidatë që presin për t’u integruar në trupat gjyqësore dhe që duhet të mendojmë që aty ku ka pozicione të përhershme do inkludohen edhe këta kandidatë për të lehtësuar

gjykatat ku do emërohen. Kështu që flasim për të tashmen, se tek e ardhmja kemi kohë për të folur.

Ilir Rusi: Po, zonja Ukperaj!

Brikena Ukperaj: Çështja që thotë Albani që kemi 40 magjistratë që duhet t'i emërojmë nuk kanë lidhje fare me transferimet sepse transferimet janë pozicione të lira të përkohshme që zihen për një vit dhe që nuk sjellin suprimimin e pozicionit. Ai nuk kthehet në pozicion të lirë të përhershëm, e para.

E dyta, të pranojë Këshilli i Lartë Gjyqësor që nuk e dimë se çfarë do bëhet me hartën, mua më duket e gabuar, e artikuluar nga anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Kështu u tha edhe për apelin. Apeli filloi funksionimin në datën 1 shkurt. Po përgatiten aktet për të filluar funksionim për gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm më 1 maj. Bëhet fjalë vetëm për muajin prill. Pra të diskutosh për funksionalitet bazuar vetëm në muajin prill, unë nuk e di?! Funksionaliteti duhet parë në periudhë afatgjatë, 1 vit saç është edhe tek transferimi.

Tani, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin për një muaj do mbetet me dy gjyqtarë edhe Lushnja për një muaj do mbetet me 2 gjyqtarë, por e transferuam në Tiranë gjyqtaren. Atëherë, Gjykata e Kurbinit ngelet me 2 gjyqtarë, do shkojnë në Lezhë. Të gjithë gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin bashkë me gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë do kenë rishpërndarje të çështjeve të tyre në një mesatare shumë herë më të lartë seç do kenë gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë që do bashkohen në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec. Pra ne kur duam shikojmë funksionalitetin për një muaj, në raste të tjera shikojmë funksionalitetin sipas hartës. Për këtë arsye unë mendoj që gjykata e parë nga duhet të përzgjidhet, për transferim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, duhet të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë.

Ilir Rusi: Atëherë, në vijim të diskutimeve, ka diskutime të tjera nga anëtarët?
Po, zoti Toro!

Alban Toro: Meqenëse jam vijues.

E thënë nga një anëtar që ka qenë kundër kësaj harte gjyqësore dhe vazhdoj të këmbëngul në drejtësinë e opinionit tim në lidhje me të, mendoj që nuk ka asgjë jo korrekte për të thënë që do të shohim të ardhmen për hartën gjyqësore. Do të jetë e shpejtë koha kur do detyrohet KLGJ-ja të krijojë një hartë tjetër gjyqësore, për efekt të problemeve që ka hapur.

Në lidhje me atë që unë thashë, thjesht u mbështeta tek parimet dhe kriteret e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, i cili kërkon distancën, ngarkesën për gjyqtar dhe për gjykatë. Të gjitha këto përfshihen tek pjesa e përzgjedhjes që na kanë detyruar të marrim midis Kurbinit dhe Korçës, ku ngarkesat janë relativisht të pakta në Kurbin; dhe po t'i shtojmë edhe të ardhmen, nëse do ta marrim në bashkim me Lezhën, do të jetë e njëjta situatë.

Gjithsesi, kur përmenda që do të vijmë 40 kandidatë të rinj, këtë e përmenda për çështje funksionaliteti, që do të thotë, edhe për ato pozicione të përhershme që janë hapur, sepse thatë që nga Kurbini do të largohet një person, një gjyqtar do të dalë në pension, kështu që vendi i tij me siguri do të zihet apo do të caktohet një person apo kandidat nga studentët që do dalin nga Shkolla e Magjistraturës.

Kështu që çështja e funksionalitetit në lidhje me këto pozicionet e përhershme pothuajse është e zgjidhur sepse siç thashë janë 40 kandidatë që presin të integrohen në trupën gjyqësore dhe patjetër do të duhet që këta kandidatë të integrohen në këto pozicione të përhershme. Kjo ishte për pozicionet e përhershme. Ndërsa pozicionet e përkohshme, aktualisht parimet i kemi respektuar, kriteret janë respektuar, si me të ardhmen dhe me të tashmen. Kështu që, ndaj të njëjtin opinion me Komisionin dhe jam që të mbetet në fuqi ky projektvendim.

Ilir Rusi: Ka të tjera diskutime?

Po, zonja Shehu!

Marçela Shehu: Faleminderit!

Atëherë, duke qenë se disa nga diskutimet lidheshin edhe me situatat që mund të ndodhin, hipotetike, atëherë, në lidhje me funksionalitetin e Gjykatës Lezhë, gjykatës së riorganizuar në datën 1 maj 2023, sjell në vëmendje që nga ekspertët që kanë asistuar

Këshillin është vlerësuar që numri i gjyqtarëve të kësaj gjykate të shkojë në 12 gjyqtarë. Sigurisht që kjo është një hipotezë, është një projekt, i cili do të kalojë për diskutim në mbledhjen plenare të Këshillit, por gjithsesi është një arsye që duhet të konsiderohet nga Këshilli në lidhje me funksionalitetin e kësaj gjykate, e cila në rastin që Këshilli do të vlerësojë si pozitiv mendimin e ekspertëve, numri i gjyqtarëve në këtë gjykatë do të shkojë në 12. Pra nuk besoj se do të kemi më diskutim në lidhje me cenimin e funksionalitetit. Kemi më pas ata 40 magistratët që thotë edhe zoti Toro, të cilët do të plotësojnë vakancat në pozicionet e përhershme të lira.

Ilir Rusi: Po, zonja Ukperaj!

Brikena Ukperaj: Për të vazhduar diskutimin e Marçelës, për të parë edhe në një këndvështrim afatgjatë, sikundër është propozuar numri 12 për Lezhën, është propozuar numri 15 për Korçën, çka do të thotë që aty dëmtimi i funksionalitetit do të jetë shumë-shumë minimalist, krahasuar me ngarkesën e çështjeve që do të ketë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë me atë që do të ketë Gjykata e Lezhës, për arsye se ka diçka, aty ka volum çështjes sepse ka pasur gjithmonë shkarkime gjyqtarësh, lëvizje gjyqtarësh në skemë delegimi ose në transferime, që Korça nuk është prekur. Kjo ka qenë arsyeja. Jo sepse Lezha ka pasur më shumë çështje se Korça. Pra aty ka “backlog” të mbledhur në Lezhë, që Korça nuk e ka këtë “backlog”. Faleminderit!

Ilir Rusi: Ka diskutime nga anëtarët e tjerë të Këshillit të Lartë Gjyqësor?

Meqenëse nuk ka diskutime, do kërkoja perifrazimin e propozimit.

Brikena Ukperaj: Propozimi është që të mos përfshihet Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin por të përfshihet Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë. Ndërkohë me Sarandën jam dakord.

Ilir Rusi: Atëherë, nëse nuk ka diskutime të tjera, vazhdojmë në hedhjen në votim të propozimit të bërë nga zonja Ukperaj në lidhje me gjykatat që do përfshihen.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Kundër.

Ridvan Hado: Kundër.

Alban Toro: Kundër.

Fatmira Luli: Kundër.

Marçela Shehu: Kundër.

Yllka Rupa: Kundër.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Kundër.

Ilir Rusi: Kundër.

Atëherë, rrezohet propozimi përkatës.

Vazhdojmë me perifrazimin edhe një herë...

Po, zonja Ukperaj!

Brikena Ukperaj: Atëherë, propozimi im i dytë lidhet me gjyqtarin e përzgjedhur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë. Në qoftë se do shohim relacionin, në fakt evidentohet në relacion që dy gjyqtarët znj. {...} dhe z. {...} kanë tre vjet përvojë profesionale. Në fakt nga të dhënat nuk është e saktë kjo sepse zonja {...} është emëruar në datën 19.07.2019 dhe ka një përvojë profesionale prej 3 vjet e 6 muaj, ndërkohë që zoti {...} është emëruar në 9.01.2020 dhe ka përvojë profesionale 3 vjet. Pra zonja {...} ka 6 muaj përvojë profesionale më të gjatë se gjyqtari {...}.

Nga ana tjetër, nga të dhënat e relacionit, rezulton që gjyqtari {...} ka ngarkesën më të madhe të çështjeve në Gjykatën e Sarandës (shkojnë rreth 350 e ca çështje), ndërkohë që zonja {...} kishte rreth 190 e ca çështje. Kështu që, për të respektuar motamo rregulloren, propozoj që të transferohet gjyqtari që ka vjetërsinë më të gjatë dhe që ka ngarkesën më të vogël çështjesh.

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Ukperaj!

Po, zoti Kurushi!

Klodian Kurushi: Faleminderit!

Atëherë, në lidhje me vjetërsinë, bëtë mirë atë pjesën e krahasimeve. E vërtetë, thatë që zonja {...} ka 3 vjet e 6 muaj dhe zoti {...} nuk ka 3 vjet, por po t'i hyjmë me muaj ka 3 vjet e 3 muaj.

Brikena Ukperaj: Ka 3 vjet në momentin e aplikimit.

Klodian Kurushi: Po atëherë edhe zonja {...} është emëruar në shtator.

Brikena Ukperaj: Është emëruar në korrik.

Klodian Kurushi: Ka filluar punë në shtator.

Por emërimin e ka marrë në fund të korrikut dhe ka filluar punë në shtator.

Pse duhet ta çojmë nivelin e diskutimit deri në këtë pikë?

(Disa nga anëtarët flasin pa ndezur mikrofonat.)

Klodian Kurushi: Qartë. Më lini ta shpjegoj.

Diferenca, që ta kuptojnë të tjerët, se ju të gjithë e kuptoni këtu, njëra ka filluar punë në korrik si gjyqtare, ndërsa kandidati tjetër ka filluar punë në janar të vitit tjetër (4 muaj diferencë). Por neve nuk e pamë të arsyeshme që t'i kemi në konsideratë këto 4 muaj sepse janë në të njëjtin nivel.

Po e them se si u zgjodh në proporcionalitet. Ne këtu nuk jemi në shkencë ekzakte. Po jua them edhe një herë këtë pjesën. Siç do t'i bëni edhe ju, siç i kemi bërë edhe ne. Kështu është kjo shkenca jonë, është shumë shoqërore, nuk është fare ekzakte, -e para. E dyta, në lidhje me ngarkesën, kemi marrë në konsideratë faktin se zonja {...} që është gjyqtare, është zëvendëskryetare e gjykatës, ka edhe një detyrë administrative, dhe kjo është arsyeja pse ne na bëri të mendojmë që në këtë rast, prioritet në vlerësimin tonë si Komision (mund ta vlerësojmë ndryshe), merrte përparësi kandidati z. {...}. Kjo është arsyeja pse kemi përzgjedhur në këtë rast zotin {...}. Ngarkesa e Sarandës është relativisht e lartë aktualisht, por duke marrë parasysh këto situata dhe këto rrethana që unë ju thashë, zëvendëskryetare me një ngarkesë relativisht të lartë, e menduam që zoti

{...} mund të ishte më i përshtatshëm për të qenë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës. Faleminderit! Këto janë arsytet tona.

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Kurushi!

Ka diskutime të tjera nga anëtarët?

Po, zonja Ukperaj!

Brikena Ukperaj: Atëherë, kur diskutojmë përvojën profesionale, është ekzakte dhe nuk mund të jetë shoqërore sepse është një llogari (data e emërimit, data e paraqitjes së kërkesës). Ne këtë punë bëjmë në të gjitha rastet kur gjyqtarët kandidojnë për ngritje në detyrë dhe lëvizje paralele. Kështu që, nuk e di nëse ka ndonjë metodologji tjetër të llogaritjes së kësaj gjëje.

E dyta, qenia apo jo në detyrën e zëvendëskryetarit nuk është kusht pengues dhe as nuk është një pozicion që rregullorja i jep mundësi Komisionit të ketë një diskrecion të ndryshëm për gjyqtarin që do të përzgjedhë. Pra nëse ne shohim rregulloren, rregullorja thotë: funksionalitet, dobi, gjykatë e afërt dhe në qoftë se të gjitha këto plotësohen dhe plotësohen për Sarandën, do zgjidhet gjyqtari me përvojën profesionale më të gjatë, sikurse edhe një ditë. E them këtë gjë sepse Këshilli e ka mbajtur këtë qëndrim në transferimet e tjera që ka bërë. Edhe kur gjyqtarët kanë pasur diferenca me muaj, janë transferuar atë që kanë pasur përvojë profesionale më të gjatë. Nëse përvoja profesionale ka qenë e barabartë, atëherë ne kemi proceduar me short në transferimet e tjera. Në këtë rast është 6 muaj më e gjatë përvoja profesionale. Nëse sot do të kandidonte për një pozicion ku 6 muajshi luante rol, sigurisht që do ishte kualifikuar ajo dhe nuk do ishte kualifikuar kandidati tjetër.

Prandaj unë propozoj që në këtë rast, për Sarandën, të transferohet gjyqtari që ka përvojën më të gjatë profesionale si gjyqtar në atë gjykatë dhe që është zonja {...}.

Ilir Rusi: Faleminderit!

Ka diskutime apo propozime të tjera?

(Nuk ka diskutime.)

Atëherë, meqenëse nuk ka diskutime të tjera, do kërkoja nga zonja Ukperaj perifraximin e propozimit me qëllim që ta hedh në votim, duke qenë se është i kundërt me atë propozim të ardhur nga KZHK-ja.

(Dikush nga anëtarët flet pa ndezur mikrofonin.)

Unë mendoj që duhet hedhur propozimi kundër në votim sepse tashmë në lidhje me propozimet e bëra nga KZHK-ja me arsyetimin përkatës jemi të njohur kohë më parë. Ndërsa në lidhje me diskutimet dhe në arritjen në një propozim, është ajo që çfarë u diskutua dhe prandaj them të hedhim në fillim propozimin.

Po, zonja Ukperaj, perifraxo propozimin dhe ta hedhim në votim.

Brikena Ukperaj: Propozimi im është që, në një nga projektvendimet, në vend të gjyqtarit të propozuar zotit {...}, të zëvendësohet me gjyqtaren znj. {...}. Pra është thjesht zëvendësimi i emrit.

Ilir Rusi: Atëherë vazhdojmë me votimin e propozimit të bërë nga zonja Ukperaj.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Kundër.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Kundër.

Fatmira Luli: Kundër.

Marçela Shehu: Kundër.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Kundër.

Ilir Rusi: Kundër.

Atëherë, rrezohet propozimi.

Ilir Rusi: Vazhdojmë me propozimin e bërë nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. (ripërsëritet)

Atëherë, sipas rendit të ditës (e drejtë është), jemi duke diskutuar pikën 2 të rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i

Zhvillimit të Karrierës. U relatua nga z. Kurushi. Pati propozime në diskutim të saj dhe në raport edhe me gjykatat nga do përfshiheshin gjyqtarët, në raport edhe me emrat përkatësisht të magistratëve, dhe pika e parë është “Për transferimin e përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, të gjyqtarit z. {...}” dhe pika dy është “Për transferimin e përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, të gjyqtarit z. {...}”. Vazhdojmë me votimin e z. {...}, pastaj me zotën {...}.

Irena Plaku: Unë jam kundër, për sa kohë që isha pro për propozimin për të propozuar Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë, ndër të cilat, sipas vjetërsisë përfshinte z. Ervin Sula.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro, në momentin kur ra propozimi i paraqitur nga znj. Lubonja.

Brikena Ukperaj: Dakord, për shkak sepse Këshilli votoi që Kurbini duhet të ishte gjykata që duhet të përzgjidhej dhe zoti {...} kishte përvojën më të gjatë profesionale nga kandidatët.

Fatmira Luli: Dakord. (Rivoton)

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord me propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

Vendim “Për transferimin e përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, të gjyqtarit z. {...}”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Transferimin e përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës të gjyqtarit z. {...}, për një periudhë deri në një vit, që mund të ndërpritet në rast të ndryshimit të rrethanave që kushtëzuan transferimin.

2. Efektet juridike të transferimit të përkohshëm fillojnë më datë 13.03.2023.

3. Gjyqtari {...} përjashtohet menjëherë nga procedurat e ndarjes së çështjeve gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin.

4. Gjyqtari {...} ngarkohet të përfundojë të gjitha çështjet civile që kanë kaluar në seancë gjyqësore dhe çështjet penale të cilat janë në fazën e konkluzioneve përfundimtare si në seancë paraprake, ashtu edhe seancë gjyqësore, si dhe ato në çdo gjykatë tjetër i caktuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor. Çështjet e tjera gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin dorëzohen menjëherë prej tij.

5. Efektet financiare sipas këtij vendimi përballohen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës.

6. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarit të transferuar përkohësisht z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ilir Rusi: Për më tej vazhdojmë me votimin në lidhje me projektvendimin mbi magistratin zotin {...}.

Irena Plaku: Kundwr.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Kundwr.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për transferimin e përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, të gjyqtarit z. {...}”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Transferimin e përkohshëm me pëlqim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës

të gjyqtarit z. {...}, për një periudhë deri në një vit, që mund të ndërpritet në rast të ndryshimit të rrethanave që kushtëzuan transferimin.

2. Efektet juridike të transferimit të përkohshëm fillojnë më datë 13.03.2023.

3. Gjyqtari {...} përjashtohet menjëherë nga procedurat e ndarjes së çështjeve gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë.

4. Gjyqtari {...} ngarkohet të përfundojë të gjitha çështjet civile që kanë kaluar në seancë gjyqësore dhe çështjet penale të cilat janë në fazën e konkluzioneve përfundimtare si në seancë paraprake, ashtu edhe seancë gjyqësore, si dhe ato në çdo gjykatë tjetër i caktuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor. Çështjet e tjera gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë dorëzohen menjëherë prej tij.

5. Efektet financiare sipas këtij vendimi përballohen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës.

6. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarit të transferuar përkohësisht z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 06.03.2023)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për emërimin gjyqtar të z. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 09:49 dhe mbaroi në orën 14:38.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Irena Plaku | (anëtare) |
| 5. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 6. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 7. Alban Toro | (anëtar) |
| 8. Marçela Shehu | (anëtare) |
| 9. Brikena Ukperaj | (anëtare) |
| 10. Yllka Rupa | (anëtare) |

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 3. Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 4. Valbona Bala, eksperte (EWMI-INL).**
- 5. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.**
- 6. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.**
- 7. Të tjerë: Paola Ndroqi (Universiteti “Epoka”), Edmond Hoxhaj (Birn).**

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Për emërimin gjyqtar të z. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Ilir Rusi: Për më tej vazhdojmë me pikën tre të rendit të ditës që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për emërimin gjyqtar të z. {...}”, për të cilin është përgatitur relacioni përkatës nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Për më tej relator, zoti Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit zoti Rusi!

Parashtrijmë projektvendimin përkatës për emërimin gjyqtar të zotit {...}. Bashkëlidhur po prezantoj në mënyrë shumë të përmbledhur relacionin përkatës.

Relacioni përpilohet duke u bazuar në nenin 136/a, 147/a, pika 1, shkronja “a”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në nenin 35 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 61, pika 2, shkronja “a”, nenin 86, shkronja “a” dhe nenin 97, pika 1, të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe

mbështetur në vendimin nr. 84, datë 16.02.2023, “Për kualifikimin për emërim të kandidatit të diplomuar në shkollën e magistraturës, z. {...}”.

Këshilli, pasi përfundoi procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin si gjyqtar të kandidatit z. {...}, sipas vendimit të Këshillit nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, të ndryshuar, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, miratoi vendimin nr. 84, datë 16.02.2023, me të cilin, pasi u konkludua se për kandidatin z. {...} nuk ka të dhëna që mund të sjellin skualifikimin nga kandidimi për emërim si gjyqtar, u vendos kualifikimi i tij dhe vijimin e procedurës së emërimit.

Vlerësimi i Komisionit:

Në vijim të kësaj procedure, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka hartuar projektvendimin “Për emërimin gjyqtar të z. {...}”, sipas të cilit, kandidati {...}, i diplomuar në Shkollën e Magistraturës në vitin akademik 2021-2022, emërohet “gjyqtar”, ndërsa ai plotëson kushtet dhe kriteret e emërimit sipas nenit 136/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 35 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Sipas pikës 2 të projektvendimit parashikohet se një kopje e këtij vendimi duhet t’i njoftohet gjyqtarit të emëruar.

Së fundi, vendimi përcakton momentin e hyrjes në fuqi të tij, që është pikërisht menjëherë dhe bëhet publikimi në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Bashkëlidhur është edhe projektvendimi përkatës.

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Kurushi!

Ka diskutime?

(Nuk ka diskutime.)

Atëherë, vazhdojmë hedhjen në votim të projektvendimit përkatës.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Illir Rusi: Dakord.

Vendim “Për emërimin gjyqtar të z. {...}”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Të emërojë gjyqtar z. {...}.
2. Një kopje e këtij vendimi t’i njoftohet kandidatit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 06.03.2023)

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 280, datë 10.12.2019, “Për caktimin e gjyqtarëve për mediat”, i ndryshuar”, i përgatitur nga i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit (relatore znj. Marçela Shehu).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 09:49 dhe mbaroi në orën 14:38.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Irena Plaku | (anëtare) |
| 5. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 6. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 7. Alban Toro | (anëtar) |
| 8. Marçela Shehu | (anëtare) |
| 9. Brikena Ukperaj | (anëtare) |
| 10. Yllka Rupa | (anëtare) |

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 4. Valbona Bala, eksperte (EWMI-INL).*
- 5. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
- 6. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*
- 7. Të tjerë: Paola Ndroqi (Universiteti “Epoka”), Edmond Hoxhaj (Birn).*

RENDI I DITËS:

4. Shqyrtimi i projektvendimit “Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 280, datë 10.12.2019, “Për caktimin e gjyqtarëve për mediat”, i ndryshuar”, i përgatitur nga i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit (relatore znj. Marçela Shehu).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën 4 të rendit të ditës, që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 280, datë 10.12.2019, “Për caktimin e gjyqtarëve për mediat”, i ndryshuar”, relacioni përkatës i përgatitur nga komisioni, dhe për më tej fjalën ia jap zonjës Shehu.

Marçela Shehu: Faleminderit zoti Zëvendëskryetar!

Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit ka paraqitur për shqyrtim mbledhjes plenare projektvendimin “Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 280, datë 10.12.2019, “Për caktimin e gjyqtarëve për mediat”, i ndryshuar”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 91, pika 3 e ligjit 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, me vendimin nr. 280, datë 10.12.2019, të ndryshuar me vendimet nr. 292, datë 06.07.2021; nr. 424, datë 29.09.2021; nr. 254, datë 07.07.2022 dhe nr. 515, datë 21.11.2022, ka vendosur caktimin e gjyqtarëve, si më poshtë, në pozicionin e gjyqtarit për mediat për çdo juridiksion apeli, konkretisht: {...}, juridiksioni i Apelit Shkodër; {...}, juridiksioni i Apelit Tiranë; {...}, juridiksioni i Apelit Durrës; {...}, juridiksioni i Apelit Vlorë; {...}, juridiksioni i Apelit Korçë; {...}, juridiksioni i Apelit Gjirokastrë; {...}, juridiksioni i Apelit Administrativ; {...}, juridiksioni i Apelit për Krime të Rënda / për gjykimin e veprave penale të krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Këshilli i Ministrave me vendimin nr. 495, datë 21.7.2022 “Për riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave” në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 13, të ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ka vendosur:

1. Gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm riorganizohen në 13 (trembëdhjetë) gjykata të rretheve gjyqësore me kompetenca tokësore (siç përcaktohen në këtë vendim).

2. Gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm riorganizohen në një Gjykatë Apeli të Juridiksionit të Përgjithshëm, që organizohet dhe funksionon në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, me seli në qytetin e Tiranës.

3. Gjykatat administrative të shkallës së parë riorganizohen në 2 (dy) gjykata administrative të shkallës së parë me kompetenca tokësore (sipas asaj që përcaktohet në këtë vendim).

Neni 91 i ligjit 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, evidenton rolin e Këshillit të Lartë Gjyqësor si përgjegjës për mbarëvajtjen e marrëdhënieve të gjyqësorit me publikun. Ndër të tjera, në pikën 3 të kësaj dispozite parashikohet se: “Këshilli i Lartë Gjyqësor cakton të paktën një gjyqtar për mediat për çdo juridiksion apeli...”

Për shkak të riorganizimit të rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave, me qëllim garantimin e përmbushjes së detyrimit kushtetues për informimin e publikut në lidhje me veprimtaritë e gjykatës, në mënyrë të saktë, të shpejtë dhe

efektive, Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit ka propozuar caktimin e gjyqtarëve për mediat në çdo juridiksion apeli, duke shtuar numrin e gjyqtarëve për mediat të caktuar në juridiksionin e apelit të përgjithshëm, duke propozuar konkretisht mundësinë e caktimit të gjyqtarëve për mediat në çdo gjykatë të rretheve gjyqësore.

Paraprakisht, i është kërkuar mendimi i të gjitha gjykatave, me qëllim propozimin nga ana e tyre, të gjyqtarit më të përshtatshëm për të kryer këtë detyrë dhe që gëzonte besimin e kolegëve.

Bazuar sa më sipër është përgatitur edhe projektvendimi për ndryshimin e vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 280, datë 10.12.2019 “Për caktimin e gjyqtarëve për mediat”.

Në pikën 1 të projektvendimit përcaktohet ndryshimi i pikës 1 të vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 280, datë 10.12.2019, “Për caktimin e gjyqtarëve për mediat”, duke propozuar caktimin e gjyqtarëve përkatës.

Në pikën 2 të projektvendimit përcaktohet se ngarkohen gjyqtarët për mediat dhe gjykatat përkatëse të marrin masat për zbatimin e këtij vendimi.

Së fundi, në projektvendim përcaktohet dhe hyrja në fuqi menjëherë e këtij vendimi.

Ndërsa në projektvendim janë cituar emrat e të gjithë gjyqtarëve që propozohen që të ushtrojnë funksionin e gjyqtarit për mediat, emra këto (që e theksoj) që janë propozuar nga vetë gjykatat pas diskutimit që kanë pasur gjyqtarët me njeri-tjetrin, duke propozuar gjyqtarët që ata mendojnë që mund të jenë më të përshtatshëm për të ushtruar këtë funksion.

Ky është edhe projektvendimi që Komisioni i paraqet për shqyrtim mbledhjes plenare.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Shehu!

Ka diskutime nga anëtarët?

(Nuk ka diskutime.)

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me hedhjen në votim të projektvendimit përkatës.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Dakord.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 280, datë 10.12.2019, “Për caktimin e gjyqtarëve për mediat”, i ndryshuar”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Ndryshimin e pikës 1 të vendimit nr. 280, datë 10.12.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të ndryshuar, si më poshtë:

Caktimin e gjyqtarëve të mëposhtëm, në pozicionin e gjyqtarit për mediat, për çdo juridiksion apeli:

Në Juridiksionin e Përgjithshëm të Apelit:

1. znj. {...} – Gjyqtare për median pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm;

2. znj. {...} – Gjyqtare për median pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë;

3. z. {...} – Gjyqtar për median pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan;

4. z. {...} – Gjyqtar për median pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë;

5. znj. {...} – Gjyqtare për median pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat;

6. z. {...} – Gjyqtar për median pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë;

7. z. {...} – Gjyqtar për median pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë;

8. znj. {...} – Gjyqtare për median pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë;

9. z. {...} – Gjyqtar për median pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier;

10. znj. {...} – Gjyqtare për median pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës;

11. znj. {...} – Gjyqtare për median pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë;
12. znj. {...} – Gjyqtare për median pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës;
13. z. {...} - Gjyqtar për median pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër;
14. z. {...} – Gjyqtar për median pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Në Juridiksionin e Apelit Administrativ:

1. znj. {...} – Gjyqtare për median pranë Gjykatës Administrative të Apelit;

Në Juridiksionin e Apelit për gjykimin e veprave penale kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar:

1. znj. {...} – Gjyqtare për median pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.

2. Ngarkohen gjyqtarët e caktuar për mediat dhe gjykatat përkatëse të marrin masat për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ilir Rusi: Atëherë, të nderuar anëtarë, vazhdojmë me pikën 5, por meqenëse pika 5, për shkak të natyrës, kjo çështje do të trajtohet me dyer të mbyllura.

Ndërpresim komunikimin me të tretët nëpërmjet platformës “online”, duke larguar nga salla edhe personat të cilët nuk mund të jenë prezent në këtë mbledhje, për shkak të natyrës së saj.

Shqyrtojmë pikën 5 të renditë të ditës dhe do të vazhdojmë më tej, me pikën 6, 7, 8, dhe pikën 9 dhe 10 të shtuar me votim ditën e sotme.

Faleminderit!

* * *

(Pika 4 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 06.03.2023)

Pika 6 e rendit të ditës me objekt: Zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës. (shtyrë nga mbledhjet plenare të datës 22.12.2022, 19.01.2023, 13.02.2023).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 09:49 dhe mbaroi në orën 14:38.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Irena Plaku | (anëtare) |
| 5. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 6. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 7. Alban Toro | (anëtar) |
| 8. Marçela Shehu | (anëtare) |
| 9. Brikena Ukperaj | (anëtare) |
| 10. Yllka Rupa | (anëtare) |

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 3. Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 4. Valbona Bala, eksperte (EWMI-INL).**
- 5. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.**
- 6. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.**
- 7. Të tjerë: Paola Ndroqi (Universiteti “Epoka”), Edmond Hoxhaj (Birn).**
- 8. Përfaqësuesit e ILD-së, znj. {...} dhe z. {...}.**

RENDI I DITËS:

6. Zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës. (shtyrë nga mbledhjet plenare të datës 22.12.2022, 19.01.2023, 13.02.2023).

(Futen në sallën e mbledhjes znj. {...} dhe z. {...}, përfaqësues të ILD-së.)

Ilir Rusi: Përshëndetje!

Sikundër jeni njoftuar, vazhdojmë me pikën 6 të rendit të ditës, zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës (shtyrë nga mbledhjet plenare të datës 22.12.2022, 19.01.2023, 13.02.2023). Seanca dëgjimore ishte parashikuar sot, për më datë 6 mars 2023, ora 11:00, por për shkak të vijimit të mbledhjes plenare prej orës 9:30 e në vijim dhe çështjeve që

kishim për të diskutuar, atëherë në këtë moment kohor është radha për të shqyrtuar pikën 6 të rendit të ditës të mbledhjes së sotme, të njoftuar kohë më parë (Shih hyrjen në procesverbalin e pikës së dytë të rendit të ditës.)

Sipas njoftimeve të marra në kohë, rezulton që zoti {...}, prej datës 19 shkurt, deri në datën 5 mars rezulton të jetë me raport mjekësor, ndërsa sot më datë 06.03.2023 është i aftë për punë. Deri më tani nuk kemi asnjë njoftim prej tij mbi pjesëmarrjen e tij, personalisht apo paraqitjen e çdo lloj dokumenti justifikues.

Meqenëse në seancën e sotme dëgjimore, sikundër ka ndodhur edhe kohë më parë, me autorizimin përkatës nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, janë personat e autorizuar prej tij, znj. {...} dhe z. {...}, do kërkoja mendimin e tyre për vijueshmërinë e mëtejshme të këtij procesi.

Atëherë, meqenëse relatori i çështjes, zoti Hado, kërkon fjalën, do kërkoja mirëkuptimin tuaj që të parashtronte situatën.

Ridvan Hado: Nga administrata e KLGJ-së jam vënë në dijeni që zoti {...} ka njoftuar nëpërmjet mjeteve elektronike që ndodhet në ambulancë për të ripërsëritur raportin. Ky është informacioni, por nuk kemi konfirmim zyrtar. Faleminderit!

Ilir Rusi: Nga relatori na u parashtrua fakti që zoti {...} ka një prezencë të tij fizike në poliklinikë për t'u pajisur me raportin mjekësor të radhës, sepse nga dokumentet rezulton që ka një raport të pandërprerë prej kohësh. Kështu që për më tej fjala për ju.

{...}: Faleminderit i nderuar drejtues i seancës.

Pavarësisht se në dukje, duket sikur ne nuk kemi një dokument që të themi është shkak i arsyeshëm i mosparaqitjes në seancë të magjistratit, gjithsesi unë duke u konsultuar edhe me kolegun tim, mendoj që duhet të mirëkuptojmë kërkesën e tij, nisur nga fakti që është për shkaqe shëndetësore, nisur nga fakti që i ka mbaruar dje raporti i parë dhe vijueshmëria kërkon një kohë sa të mblidhet komisioni administrativ që të nxjerrë raportin vijues, unë mendoj që të mirëkuptojmë magjistratin. Pranojmë kërkesën. Unë them t'i japim edhe një herë mundësinë ta njoftojmë përsëri, edhe për një proces të rregullt ligjor, që të mos kemi nesër pretendime të kësaj natyre në seancat vijuese.

Ilir Rusi: Atëherë, meqenëse ju jeni prezent, sa kohë është kjo e arsyeshme për ta shtyrë, duke pasur në konsideratë edhe angazhimet tuaja?

{...}: Unë mendoj 15 ditë?

Ilir Rusi: Relator? Fjala për ju zoti Hado!

Ridvan Hado: Në kushtet e mësipërme, duke respektuar edhe nenin 116 të ligjit “Për statusin”, paragrafin e parë, jam i mendimit që ta shtyjme seancën dëgjimore. Nga ana tjetër, t’i bëjmë me dije magjistratit {...} që në seancën e ardhshme, nëse është në pamundësi për të ardhur, të zgjedhë një mbrojtës për të mbrojtur të drejtat e tij. Seanca e ardhshme në çmim të Këshillit. Afatin maksimal e kemi 30 ditë. Në datën 3, 4, 5, të muajit pasardhës, jemi brenda afatit. Faleminderit!

Ilir Rusi: Propozimi i përfaqësuesit të Inspektorit është për dy javë, që rezulton të jetë data 20 mars, ndërkohë, relatori na prezantoi që kemi edhe një marzh tjetër kohe, atëherë sa mendoni të jetë, pas dy javësh apo pas tre javësh apo në kufijtë maksimal të kohës që kemi mundësi për ta shtyrë këtë seancë?

Relator, fjala për ju!

Ridvan Hado: Jam i mendimit që më datë 4 prill, t’i japim mundësi që të zgjedhë edhe avokat dhe të njihet me aktet avokati (nëse nuk do të paraqitet vetë).

(Disa nga anëtarët e Këshillit shprehen se janë në trajnim më datë 4 prill.)

Ridvan Hado: Me datë 5, ora 11:00.

Ilir Rusi: Nisur nga propozimi i relatorit, nga disponibiliteti i anëtarëve dhe duke marrë në konsideratë edhe impenjimet e përfaqësuesve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, seanca e radhës dëgjimore për magjistratin {...}, do të përcaktohet në datën 5 prill 2023, ora 11:00, ditë e mërkurë. (Ripërsëritet data dhe ora.)

Faleminderit!

(Largohen nga salla e mbledhjes përfaqësuesit e ILD-së.)

* * *

(Pika 6 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 06.03.2023)

Pika 7 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për një ndryshim në listën e gjyqtarëve udhëheqës të caktuar me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 252, datë 07.07.2022”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Brikena Ukperaj).

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 09:49 dhe mbaroi në orën 14:38.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Irena Plaku | (anëtare) |
| 5. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 6. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 7. Alban Toro | (anëtar) |
| 8. Marçela Shehu | (anëtare) |
| 9. Brikena Ukperaj | (anëtare) |
| 10. Yllka Rupa | (anëtare) |

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 3. Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 4. Valbona Bala, eksperte (EWMI-INL).**
- 5. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.**
- 6. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.**
- 7. Të tjerë: Paola Ndroqi (Universiteti “Epoka”), Edmond Hoxhaj (Birn).**

RENDI I DITËS:

7. Shqyrtimi i projektvendimit “Për një ndryshim në listën e gjyqtarëve udhëheqës të caktuar me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 252, datë 07.07.2022”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore *znj. Brikena Ukperaj*).

Ilir Rusi: Vazhdojmë me pikën 7 të rendit të ditës, shqyrtimi i projektvendimit “Për një ndryshim në listën e gjyqtarëve udhëheqës të caktuar me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 252, datë 07.07.2022”, për të cilin është përgatitur relacioni përkatës nga Komisioni. Për më tej ia jap fjalën relatores, *znj. Ukperaj*.

Brikena Ukperaj: Faleminderit zoti Rusi!

Atëherë, ky projektvendim që i paraqitet për miratim sot mbledhjes plenare, sillet për shkak të pamundësisë objektive të dy gjyqtarëve të caktuar si magjistrat udhëheqës për praktikën profesionale të kandidatëve për gjyqtarë në vitin e tretë të Shkollës së Magjistraturës. Në listën e gjyqtarëve udhëheqës të atashuar pranë kandidatëve për

magjistratë gjatë praktikës profesionale të tyre për sesionin e tretë 4-mujor, mars-qershor 2023, kanë qenë edhe dy gjyqtarët {...} dhe zoti {...}.

Zonja {...} na ka njoftuar me e-mail për pamundësinë e saj objektive për të qenë në detyrë për shkak se ajo ka marrë lejen e barrë lindjes dhe në këto kushte është në pamundësi objektive për të ndjekur praktikën profesionale të kandidatëve për gjyqtarë; dhe zoti {...} është shkarkuar nga detyra me vendim të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pra ka një shkak që sjell mbarimin më mënyrë të menjëhershme të statusit të gjyqtarit.

Për këtë arsye, komisioni i propozon mbledhjes plenare që të dy këta magjistratë udhëheqës të zëvendësohen me dy gjyqtarë të tjerë të cilët janë pjesë e listës së gjyqtarëve udhëheqës, të miratuar nga Këshilli, janë pjesë e seksionit penal, dhe njëkohësisht tashmë kanë nga një kandidat në procedurë mentorimi. Duhet të kemi parasysh që numri i kandidatëve është 13 dhe janë vetëm 8 gjyqtarë në seksionin penal, të cilët janë pjesë e listës së gjyqtarëve udhëheqës.

Marrë parasysh sa më sipër, duke marrë në konsideratë gjyqtarët e përfshirë në mentorim, numrin e magjistratëve të caktuar efektivisht ndaj tyre deri tani, kemi propozuar që në vend të zonjës {...}, në cilësinë e gjyqtarit udhëheqës të kandidates për magjistrate të znj. {...}, të caktohet zoti {...}, për sesionin e tretë 4-mujor, mars-qershor 2023, dhe për magjistratin tjetër zotin {...}, për sesionin e tretë 4-rmujor, në vend të gjyqtarit {...}, të caktohet gjyqtari z. {...}. Në këtë mënyrë, pothuajse të gjithë gjyqtarët e seksionit penal i kemi me nga dy kandidatë për magjistratë në mentorim.

Për këtë arsye është përpiluar edhe projektvendimi. Pika e parë parashikon pikërisht ndryshimin pjesërisht të listës me dy gjyqtarë që unë citova.

Në pikën e dytë, njoftimi shkollës dhe dy gjyqtarëve respektivë. Së fundi, hyrja në fuqi menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Ukperaj!

Ka diskutime për sa u parashtrua?

Meqenëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me hedhjen në votim të projektvendimit përkatës.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Illir Rusi: Dakord.

Vendim “Për një ndryshim në listën e gjyqtarëve udhëheqës, të caktuar me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.252, datë 07.07.2022”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse vendosi:

1. Ndryshimin pjesërisht të listës së gjyqtarëve udhëheqës, të caktuar me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 252, datë 07.07.2022, gjatë praktikës profesionale të kandidatëve për magistratë të Shkollës së Magjistraturës, viti akademik 2022-2023, duke zëvendësuar në sesionin e tretë 4-mujor, mars-qershor 2023:

a) gjyqtaren udhëheqëse znj. {...} me gjyqtarin udhëheqës z. {...} dhe;

b) gjyqtarin udhëheqës z. {...} me gjyqtarin udhëheqës z. {...}.

2. Ky vendim i njoftohet Shkollës së Magjistraturës, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe gjyqtarëve znj. {...}, z. {...}, z. {...} dhe z. {...}.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 7 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 06.03.2023)

Pika 8 shtesë e rendit të ditës me objekt: Për caktimin me short të relatorit të procedimit disiplinor nr. 1/2023, të filluar ndaj magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës.

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 09:49 dhe mbaroi në orën 14:38.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Irena Plaku | (anëtare) |
| 5. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 6. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 7. Alban Toro | (anëtar) |
| 8. Marçela Shehu | (anëtare) |
| 9. Brikena Ukperaj | (anëtare) |
| 10. Yllka Rupa | (anëtare) |

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Valbona Bala, eksperte (EWMI-INL).*
5. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
6. *Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*
7. *Të tjerë: Paola Ndroqi (Universiteti “Epoka”), Edmond Hoxhaj (Birn).*

RENDI I DITËS:

8 shtesë. Për caktimin me short të relatorit të procedimit disiplinor nr. 1/2023, të filluar ndaj magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës.

Ilir Rusi: Në vijim, sipas rendit të ditës kemi pikën 8 që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta. Me një komunikim që kemi pasur, kjo do të jetë çështja e fundit në rendin e ditës, duke qenë se si pikë e 8-të e rendit të ditës, dhe pikë 9, do të jenë çështjet që ne i votuam sot në fillim të mbledhjes, që kanë të bëjnë me procedimet disiplinore të ardhura nga ILD-ja, në lidhje me magjistratin z. {...}.

Për më tej, në lidhje me këto, procedimi 1/2023, fjalën ia jap relatores zonjës Shehu, kryetare e Komisionit Disiplinor.

Marçela Shehu: Faleminderit!

Komisioni Disiplinor i ka paraqitur për shqyrtim dhe miratim mbledhjes plenare projektvendimin “Për caktimin me short të relatorit të procedimit disiplinor nr. 1/2023, të

filluar ndaj magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës”.

Pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, me shkresën nr. {...} prot., datë 27.02.2023 është depozituar kërkesa e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës.

Kërkesa për fillimin e procedimit disiplinor mbështetet në nenin 194 të ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar, dhe në nenin 138 të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, për shkeljet disiplinore të parashikuara nga neni 140, pika 2, shkronja "a" e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 102, pika 1, shkronja "dh" dhe neni 102, pika 2, shkronja "a" e ligjit nr. 96/2016.

Në kërkesën për fillimin e procedimit disiplinor, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka paraqitur propozimin për caktimin ndaj magjistratit z. {...}, të masës disiplinore "Pezullim nga detyra, për një periudhë prej dy vitesh" të parashikuar nga neni 110 i ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Në lidhje me procedurën:

Në kushtet kur kërkesa e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor, inicion një procedurë individuale administrative në Këshill, e cila ka lidhje me statusin profesional të magjistratit z. {...}, në referim të nenit 63 të Ligjit nr. 115/2016, të ndryshuar, nga ana e Këshillit duhet të procedohet me hedhjen e shortit për caktimin e relatorit.

Lidhur me procedurën e shortit, Komisioni Disiplinor propozon që në short të përfshihen tre anëtarët e përhershëm të tij znj. Marçela Shehu, z. Ridvan Hado dhe z. Ilir Rusi, në referim të nenit 16 të vendimit nr. 316 datë 14.09.2020 të Këshillit "Për miratimin e Rregullores për Procedurat Disiplinore në Këshillin e Lartë Gjyqësor", ku përcaktohet se: "Në çdo rast, në procedurën e shortit për caktimin e relatorit të çështjes, nuk mund të marrin pjesë më pak se tre anëtarë”.

Menjëherë pas caktimit me short të relatorit, nga Këshilli duhet të procedohet me caktimin e mbledhjes plenare të radhës, në të cilën Këshilli, mbi relacionin e përgatitur

nga relatori, mund të vendosë mbylljen e procedimit disiplinor pa zhvilluar seancë dëgjimore, sipas nenit 139 të ligjit “Për statusin”, ose caktimin e datës së seancës dëgjimore sipas nenit 138/2 të këtij ligji.

Bazuar sa më sipër, si propozim të Komisionit të Disiplinës, parashtroj:

Nga sa u parashtrova, bazuar në nenin 63 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në nenin 138 e vijues të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në nenin 16 të Rregullores “Për procedurat disiplinore në Këshillin e Lartë Gjyqësor”, Komisioni Disiplinor i propozon mbledhjes plenare, zhvillimin e procedurës për caktimin me short të relatorit të procedimit disiplinor nr. 01/2023, të filluar ndaj magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës.

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Shehu!

Nëse nuk ka diskutime nga anëtarët... Po, zonja Ukperaj!

Brikena Ukperaj: Faleminderit për fjalën!

Atëherë, në këtë rast unë mendoj që do të ishte funksionale/efektive për Këshillin që të kishte një relator të vetëm për të gjitha procedurat disiplinore për zotin {...}, sepse ne kemi aktualisht një procedim disiplinor ku kemi caktuar një relator për shkeljet disiplinore të atribuara zotit {...}. Në vijim, duke qenë se bëhet fjalë për procedime disiplinore të tjera ndaj të njëjtit gjyqtar, duke qenë se duhet të vlerësohen, e para, fakte që qëndrojnë në themel të atyre procedimeve disiplinore dhe procedurat se si Këshilli duhet të veprojë nëse do të kemi tre procedime të ndara apo duhet të kemi një procedim të vetëm, vlerësoj që duhet të ketë një relator për të vlerësuar të gjitha rrethanat që lidhen me faktet që i atribuohen, me shkeljet disiplinore dhe pastaj edhe me masat disiplinore propozuese.

Ilir Rusi: Ka diskutime?

Marçela Shehu: Parimisht, ta shikosh nga jashtë, unë jam dakord, sepse nuk ka kuptim që të kemi tre procedime për të njëjtin magjistrat dhe të kemi tre relatorë. Problemi është që a mund t'ia kalojmë të njëjtit relator pa vendosur ne bashkimin e procedimeve? Dhe a mundet ta vendosim ne bashkimin e procedimeve pa kaluar në seancë dëgjimore, sepse mund të jemi në rastin që mund ta mbyllim?

Brikena Ukperaj: Ideja është që do të ishte shumë mirë që t'i shqyrtonte i njëjti relator, sepse nëse do të jemi në bashkim apo jo, ai relator që ka të parin, do të kishte para tij në shqyrtim edhe faktet e vëna në themel të dy procedimeve të ndryshme. E rëndësishme është që ne t'i caktojmë një relator. Pavarësisht se nuk parashikohet në ligj se si operohet në rastet kur janë procedime të ndryshme, por bëhet fjalë për të njëjtin gjyqtar dhe duke qenë se bëhet fjalë për të njëjtin gjyqtar, nuk mund të ketë tre relatorë të ndryshëm (mendoj unë) për tre procedime. Domethënë një relator shqyrton faktet në themel dhe pastaj orienton edhe më drejt Këshillin, për mënyrën se si do procedohet, me bashkim, veç e veç, por është njëri që e ka dhe e ka të orientuar, sepse nuk e dimë, mund të jenë faktet që lidhen me të njëjtat vendime. Për këtë arsye e kisha më tepër.

Marçela Shehu: Vetëm edhe diçka. Duhet të jenë patjetër tre anëtarë të Komisionit në short.

Brikena Ukperaj: Pikërisht pra. Ideja është që nuk është short në këtë rast. Sepse mendoni të vijmë 10 procedime për të njëjtin gjyqtar. Çfarë do bëhet?

Marçela Shehu: Kam frikën e dukjes apo e të kuptuarit se për këtë procedim të paraqitur nuk po hidhet short, nuk po i nënshtrohet procedurave të shortit.

Irena Plaku: (pa mikrofon) Për të njëjtin gjyqtar bien tre relatorë të ndryshëm. Edhe kjo nuk ka kuptim, nga dukja.

Klodian Kurushi: Më falni!

Faleminderit zoti Zëvendëskryetar!

Unë shikoj situatën që në procedimin e parë që ne kemi caktuar dhe po vijon. Aktualisht nuk kemi marrë ndonjë rrethanë ose ndonjë kërkesë nga palët në shqyrtim që të mos dakordësohen me relatorin e çështjes. Deri tani. Kështu që, të paktën në pikëpamjen ligjore, nuk përbën pengesë ligjore, domethënë nuk kemi një normë ndaluese që të thotë “relatori i cili merr një rreth çështje, të ketë pengesë për të marrë të dytën, të tretën, të katërtën ose të pestën”. Në këtë kuptim, për sa kohë nuk kemi një normë ndaluese në ligj, që na ndalon neve për të mos lejuar relatorin për të vijuar më tej edhe me marrjen në shqyrtim të kërkesave të tjera për procedim ndaj të njëjtit subjekt, unë do të dakordësohesha me këtë argumentim. Thjeshtojmë më tepër punën e Këshillit. Arsyeja: Relatori edhe në procedurën disiplinore relatori është në situatën “pares, inter pares” me të gjithë ne që jemi këtu. Kështu që në këtë pikë, do mendoja, për arsye të efektshmërisë dhe efikasitetit të procesit, do ishte mirë (por ne mund ta ndajmë bashkërisht) që njëri relator i cili ka në shqyrtim një çështje të një magjistrati profili gjyqtar, për sa kohë nuk ka një pengesë të dukshme të arsyeshme që mund ta përjashtojë nga procedimet e tjera, nuk ka pse të pengohet për të qenë relator edhe në procedimet e tjera që mund të jenë në vijimësi ndaj të njëjtit magjistrat. Faleminderit!

Ridvan Hado: Edhe unë si relator i çështjes që është në seancë, jam dakord në parim, por nuk gjej bazën ligjore si ta shmangim. Po gjetëm artificat për shmangien e shortit, nuk ka asnjë problem, jam dakord. Në të kundërt, po qe se bëhet fjalë për bashkim procedimesh, neni 140 i ligjit, por edhe neni 138 i rregullores nuk lejojnë që të bësh bashkim, sepse duhet të jenë të njëjtat fakte dhe i njëjti magjistrat. Janë të ndryshme nga një sy që i hodha unë.

Po qe se e anashkalojmë dhe e gjejmë artificën që mos e bëjmë shortin, s’ka problem fare.

Marçela Shehu: Unë personalisht jam dakord, mjafton që ne të biem dakord me standardin që do të vendosim, që në rastet kur kemi një procedim disiplinor që po vijon dhe ka një relator të caktuar, çdo procedim tjetër që do paraqitet për të njëjtin gjyqtar, t’i kalojë të njëjtit relator. Nëse ky standard miratohet nga Këshilli, unë jam dakord.

Ilir Rusi: Atëherë, ka ndonjë diskutim në vijim?

Meqenëse zonja Shehu ishte edhe relatore e çështjes për çështjen disiplinore nr. 1/2023, por në vijim do të jetë edhe çështja nr. 2/2023, meqenëse edhe fjala juaj ishte e fundit pas diskutimeve, do të kërkoja edhe një herë perifrazimin e propozimit tuaj për vijimin më tej të procedurës në rastin në fjalë.

Marçela Shehu: Unë mendoj që Këshilli të vendosë lidhur me standardin që u propozua, pra që në rastet kur kemi disa procedime dhe ndërkohë për njërin është caktuar relatori, atëherë procedimet që vijnë në vijim, t'i kalojmë të njëjtit relator.

(Disa minuta pa audio. Anëtarët konsultohen lidhur me rregulloren.)

Marçela Shehu: Mirë, atëherë unë propozimin e bëra. Kërkoj që Këshilli të vendosë në këtë moment një standard ndryshe nga sa përcaktohet në rregulloren e Këshillit. Pra në rastet kur kemi disa procedime disiplinore, të paraqitura ndaj të njëjtit magjistrat, për të cilin për një nga procedimet është caktuar relatori, atëherë edhe procedimet vijuese t'i kalojnë të njëjtit relator.

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Shehu!

Hedhim në votim propozimin e zonjës Shehu!

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Vota e zonjës Shehu nuk dëgjohej në audio.

Zonja Shehu është propozuesja.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Atëherë për shkak të miratimit të këtij propozimi, kalojmë tek miratimi i projektvendimit përkatës, duke përcaktuar që relator do të jetë zoti Ridvan Hado.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për caktimin e relatorit të procedimit disiplinor nr. 1/2023, të filluar ndaj magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Caktimin e anëtarit të Komisionit Disiplinor, z. Ridvan Hado në cilësinë e relatorit të procedimit disiplinor nr. 1/2023, të filluar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë ndaj magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës.

2. Një kopje e këtij vendimi t’i njoftohet Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe magjistratit z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

* * *

(Pika 8 shtesë e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 06.03.2023)

Pika 9 shtesë e rendit të ditës me objekt: Për caktimin me short të relatorit të procedimit disiplinor nr. 2/2023, të filluar ndaj magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor {...}.

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 09:49 dhe mbaroi në orën 14:38.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Irena Plaku | (anëtare) |
| 5. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 6. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 7. Alban Toro | (anëtar) |
| 8. Marçela Shehu | (anëtare) |
| 9. Brikena Ukperaj | (anëtare) |
| 10. Yllka Rupa | (anëtare) |

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Valbona Bala, eksperte (EWMI-INL).*
5. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.*
6. *Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.*
7. *Të tjerë: Paola Ndroqi (Universiteti “Epoka”), Edomond Hoxhaj (Birn).*

RENDI I DITËS:

9 shtesë. Për caktimin me short të relatorit të procedimit disiplinor nr. 2/2023, të filluar ndaj magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor {...}.

Ilir Rusi: Vazhdojmë më tej, me shqyrtimin e pikës 9 të këtij rendi dite, në lidhje me procedimin disiplinor nr. 2/2023. Për më tej, fjalën ia jap relatores znj. Shehu.

Marçela Shehu: Faleminderit!

Pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, me shkresën nr. {...} prot., datë 27.02.2023 është depozituar kërkesa e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor {...}.

Kërkesa për fillimin e procedimit disiplinor mbështetet në nenin 194 të ligjit nr. 115/2016, dhe në nenin 138 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin”, për shkeljet disiplinore të parashikuara nga neni 140, pika 2, shkronja “a” e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 102, pika 2, shkronja “c” i ligjit nr. 96/2016.

Në kërkesën për fillimin e procedimit disiplinor, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka paraqitur propozimin për caktimin ndaj magjistratit z. {...}, të masës disiplinore “Vërejtje publike” të parashikuar nga neni 107 i ligjit nr. 96/2016 “Për statusin”, i ndryshuar.

Bazuar në standardin dhe qëndrimin që mbajti sot Këshilli i Lartë Gjyqësor në lidhje me përcaktimin e relatorit në rastet e procedimeve disiplinore që lidhen me të njëjtin magjistrat, atëherë propozoj që si relator për shqyrtimin e procedimit disiplinor nr. 2/2023, të filluar ndaj magjistratit z. {...}, të përcaktohet z. Ridvan Hado, i cili më herët është caktuar dhe si relator për dy procedimet e tjera në ngarkim të këtij magjistrati.

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Shehu!

Nëse nuk ka diskutime, vazhdojmë me hedhjen në votim të projektvendimit përkatës, me ndryshimet të cilat sapo u prezantuan nga relatorja.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për caktimin e relatorit të procedimit disiplinor nr. 2/2023, të filluar ndaj magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor {...}”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në bazën ligjore përkatëse, vendosi:

1. Caktimin e anëtarit të Komisionit Disiplinor, z. Ridvan Hado në cilësinë e relatorit të procedimit disiplinor nr. 2/2023, të filluar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë ndaj magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor {...}.

2. Një kopje e këtij vendimi t’i njoftohet Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe magjistratit z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e

qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, brenda 5 ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Çështja e fundit në rendin e ditës, çështja me nr. 10, caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme, do të zhvillohet nëpërmjet prezencës së anëtarëve “online”.

* * *

(Pika 9 shtesë e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 06.03.2023)

Pika 10 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).¹

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 09:49 dhe mbaroi në orën 14:38.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Irena Plaku | (anëtare) |
| 5. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 6. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 7. Alban Toro | (anëtar) |
| 8. Marçela Shehu | (anëtare) |

¹ Procesverbali i kësaj çështjeje të rendit të ditës është përmbledhje. Ishte parashikuar të trajtohej si pikë e 8-të në rendin e ditës.

9. Brikena Ukperaj (anëtare)

10. Yllka Rupa (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

4. Valbona Bala, eksperte (EWMI-INL).

5. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

6. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.

7. Të tjerë: Paola Ndroqi (Universiteti “Epoka”), Edmond Hoxhaj (Birn).

RENDI I DITËS:

10. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Çështja e cila është për trajtim në vijim të mbledhjes, pas edhe pushimit të bërë nga anëtarët, lidhet me caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme.

Fjala i jepet relatorit të çështjes, për të relatuar relacionet e përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Merr fjalën zoti Kurushi për të vijuar me relatimin e të gjitha relacioneve për secilën nga kërkesat e paraqitura nga gjykatat që janë në nevojë, si vijon: Gjykata

Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, Lezhë dhe Pukë dhe pas tyre, trajtimi i relacionit që ka për objekt deklarin e përfunduar pa një vendim përfundimtar të shqyrtimit të kërkesave të ish-gjykatave të apelit Shkodër, Durrës, Korçë, Vlorë, Gjirokastrë, për kërkesa që ata kanë paraqitur në KLGJ. Aktualisht këto kërkesa, në situatën e re të krijuar, me krijimin e gjykatës së apelit të juridiksionit të përgjithshëm, këto kërkesa mbesin pa objekt.

Pasi anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime me radhën e procedurave të shortit, vijohet me relatimin e relacioneve përkatëse.

Për sa i përket kërkesës së ardhur nga **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë** ajo ka paraqitur nevojë për 19 çështje gjyqësore, (lexohen të dhënat e çështjeve që do t'i nënshtrohen procedurës së shortit sipas tabelës në relacion si dhe informacioni i detajuar në footnote, që i përket çdo çështjeje të renditur në tabelë).

Për nevojat si më lart të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë si më poshtë:

Gjykatat nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 19 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jenë Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë dhe Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër sepse sipas hartës së re gjyqësore këto gjykata do të përfshihen në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 19 (nëntëmbëdhjetë) çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 9 (nëntë): tre nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës, dy nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë dhe katër nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër.

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjeve, në ndryshim nga rregulli i zakonshëm, të mos përjashtohet nga shorti zv.kryetari në detyrë në gjykatat respektive administrative të Shkallëve të para, konkretisht: i. z. {...}, ii. z. {...}, iii. znj. {...}.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, kërkesa 1375, Etleva Gjamo.

Për çështjen nr. 4, kërkesa 9692, Marko Boshku.

Për çështjen nr. 5, kërkesa 10195, Afërdita Caco.

Për çështjen nr. 8, kërkesa 11386, Ledio Sali.

Për çështjen nr. 10, kërkesa 10197, Klodiana Veizi.

Për çështjen nr. 9, kërkesa 11384, Klarent Demiri.

Për çështjen nr. 3, kërkesa 13406, Ligorag Toshi.

Për çështjen nr. 6, kërkesa 9690, Adrian Shega.

Për çështjen nr. 12, kërkesa 9600, Mirjan Mustafaj.

Për çështjen nr. 13, kërkesa 9111, Marko Boshku.

Për çështjen nr. 11, kërkesa 9601, Afërdita Caco.

Për çështjen nr. 7, kërkesa 11385, Ledio Sali.

Për çështjen nr. 16, kërkesa 2714, Klodiana Veizi.

Për çështjen nr. 18, kërkesa 2710, Klarent Demiri.

Për çështjen nr. 19, kërkesa 2711, Etleva Gjamo.

Për çështjen nr. 2, kërkesa 9822, Ligorag Toshi.

Për çështjen nr. 14, kërkesa 9110, Adrian Shega.

Për çështjen nr. 17, kërkesa 2713, Mirjan Mustafaj.

Për çështjen nr. 15, kërkesa 2708, Marko Boshku.

Vijohet me kërkesën e ardhur nga **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë** e cila ka paraqitur nevojë për 3 çështje gjyqësore, 2 penale dhe 1 civile (lexohen të dhënat e çështjeve që do t'i nënshtrohen procedurës së shortit sipas tabelës në relacion). Për gjykimin e çështjes penale në ngarkim të të miturit në konflikt me ligjin {...}. Trupi

grykues kryesohet nga gryqtarja znj. {...} dhe anëtar gryqtari z. {...}. Gryqtari {...} ka qenë gryqtar i hetimeve paraprake.

Çështja e dytë është një çështje penale, ndaj personit nën hetim {...} me objekt: pushimin e hetimeve për veprën penale të parashikuar nga Neni 283/1. Kanë pengesë z. {...}, z. {...}, znj. {...}; z. {...}, z. {...}, z. {...}, z. {...}, të cilët janë caktuar më përpara në grykimet e çështjeve të tjera që kanë lidhje me këtë çështje.

Çështja e tretë është një çështje civile dhe kërkohet caktimi i një gryqtari për grykimin e çështjes me objekt pavlefshmëri titulli ekzekutiv. Kanë pengesë z. {...}, z. {...}, znj. {...}.

Për nevojat si më lart të Grykatës së Rrethit Gryqësor Lezhë, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gryqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gryqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gryqtarit për grykimin e një çështjeje gryqësore të veçantë, në një grykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë si më poshtë:

Grykata, nga duhet të përzgjidhet, me short, gryqtarët që do të caktohen për grykimin e 3 (tre) çështjeve gryqësore të veçanta, të jetë Grykata e Rrethit Gryqësor Kurbin.

Numri i gryqtarëve që duhet të caktohen për grykimin e 3 (tre) çështjeve gryqësore të veçanta, të jetë 2 (dy).

Propozimet vijuese janë:

Në shortimin e çështjeve, në ndryshim nga rregulli i përgjithshëm të mos përjashtohet nga shorti Kryetari në detyrë i Grykatës së Rrethit Gryqësor Kurbin, konkretisht: Z. Aurel Arapi.

Në shortimin e çështjeve, të përjashtohet Z. {...} për të cilin është përcjellë shkresa nga grykata e Kurbinut se përjashtohet nga shorti për shkak të përfundimit të statusit për shkak të moshës së pensionit; si edhe z. {...}, për të cilin është propozuar transferimi me pëlqim në Grykatën e Durrësit.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 2, kërkesa 347, gjyqtarja Alda Sadiku.

Për çështjen nr. 3, kërkesa 155, gjyqtari Aurel Arapi.

Për çështjen nr. 1, kërkesa 8/32, gjyqtarja Alda Sadiku.

Vijohet me kërkesën e ardhur nga **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë** e cila ka paraqitur nevojë për 2 çështje gjyqësore, në lëndë penale (lexohen të dhënat e çështjeve që do t'i nënshtrohen procedurës së shortit sipas tabelës në relacion). Për çështjen me të pandehur {...} dhe {...}, që është çështja e parë. Gjyqtarja {...} ka gjykuar kërkesën e prokurorisë për caktim mase sigurimi; Trupi gjykues përbëhet nga z. {...}. Nuk rezultojnë gjyqtarë të tjerë të cilët kanë pengesa të dukshme; Për çështjen e dytë me të pandehur {...}, gjyqtari z. {...} ka gjykuar kërkesën e prokurorisë për caktim mase sigurimi; Gjyqtarja znj. {...} ka gjykuar kërkesat e prokurorisë gjatë seancës paraprake dhe është shprehur me vendimin e datës 27.02.2023. Nuk rezultojnë gjyqtarë të tjerë të cilët kanë pengesa të dukshme.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë si më poshtë:

Gjykata, nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 2 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër (seksioni penal).

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 2 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 2 (dy).

Propozimet vijuese janë:

Në shortimin e çështjes, të përjashtohet nga shorti zëvendëskryetari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, konkretisht: z. Sokol Shehu.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, kërkesa 87, gjyqtarët Tonin Sterkaj dhe Arbër Çela.

Për çështjen nr. 2, penale, kërkesa 88, gjyqtari Tonin Sterkaj.

Relacioni i fundit ka për objekt deklarin e përfunduar pa një vendim përfundimtar të shqyrtimit të kërkesave të ish-gjykatave të apelit Shkodër, Durrës, Korçë, Vlorë dhe Gjirokastrë. Lexohet relacioni nga zoti Kurushi:

i. Rrethanat e faktit/ nevojat e gjykatave

Pranë Këshillit të Lartë gjyqësor në kohë të ndryshme janë administruar kërkesa për caktim gjyqtarësh për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta nga gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm. Këto kërkesa trajtohen nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i cili harton relacionin dhe i paraqet propozimet Këshillit.

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet 4/3, 147/1, 147/a, pika 1 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 90/3 e 95 të Kodit të Procedurave Administrative, në nenet 2, 89 e 97/3 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 170/1 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në vendimin nr.30, datë 14.02.2019 të Këshillit të Lartë të Gjyqësor që miratoi projektvendimin “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, i ndryshuar, pasi shqyrton relacionet dhe propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës si dhe organizon shortin, cakton gjyqtarët për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykatat në nevojë.

Një numër i caktuar kërkesash (siç përmenden në vijim të këtij relacioni) kanë ardhur prej Gjykatës së Apelit Shkodër, Gjykatës së Apelit Durrës, Gjykatës së Apelit Korçë, Gjykatës së Apelit Vlorë dhe Gjykatës së Apelit Gjirokastrë. Këto kërkesa janë administruar pranë Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, por janë të patrajuara prej saj.

ii. Trajtimi i kërkesave

Në vendimin nr. 505, datë 21.11.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për fillimin e funksionimit të gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm”, në Seksioni V Transferimi dhe menaxhimi i çështjeve gjyqësore, ndër të tjera është parashikuar se:

“Neni 6 -

1. Çështjet gjyqësore të regjistruara në Gjykatën e Apelit Tiranë, Durrës, Gjirokastrë, Korçë, Shkodër dhe Vlorë deri në datën 31.01.2023, por që nuk kanë përfunduar sipas ligjit, transferohen në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

2. Çështjet gjyqësore që transferohen në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, regjistrohen në regjistrat manualë dhe sistemin elektronik të menaxhimit të çështjeve ICMIS.

3. Për zbatimin e pikës 1 dhe 2 të këtij neni ngarkohet Departamenti i Administrimit të Gjykatave dhe Teknologjisë së Informacionit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.”

Neni 7 Menaxhimi i çështjeve gjyqësore -

1. Çështjet gjyqësore të transferuara në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm rindahen me short elektronik, në përputhje me kriteret e miratuara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

2. Çështjet gjyqësore të transferuara në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për të cilat ka filluar apo është planifikuar shqyrtimi gjyqësor në gjykatat e apelit Tiranë, Durrës, Gjirokastrë, Korçë, Shkodër dhe Vlorë, nuk i nënshtrohen rindarjes me short. Këto çështje do të vijojnë të shqyrtohen nga të njëjtët gjyqtarë.

3. Për efekt të riorganizimit, transferimit dhe menaxhimit të çështjeve, planifikimi i datave për gjykimin e çështjeve gjyqësore në gjykatat e apelit Tiranë, Durrës, Gjirokastrë, Korçë, Shkodër dhe Vlorë, bëhet deri më datë 31.12.2022. Ky rregull nuk gjen zbatim për çështjet urgjente sipas ligjit.”

Në këto kushte, kërkesat e depozituara përpara datës 01.02.2023 të gjykatave të apelit Durrës, Gjirokastrë, Korçë, Shkodër dhe Vlorë, tashmë kanë mbetur pa objekt, pasi kërkesat për çështjet gjyqësore tashmë të transferuara gjejnë zgjidhje sipas vendimit nr. 505, datë 21.11.2022.

Prandaj është vendi që Këshilli të vendosë për deklarimin e përfunduar të çështjeve pa një vendim përfundimtar, bazuar në nenin 90/3 dhe 95 të Kodit të

Procedurave Administrative, rregullimet e të cilit duhet të zbatohen nga Këshilli në çdo rast ose situatë tjetër që nuk parashikohet shprehimisht në ligjin nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes si sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, sikurse përcakton neni 97/3 i tij.

Sipas nenit 90/3 të Kodit të Procedurave Administrative, rezulton se: “Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ”.

Sipas nenit 95 të Kodit të Procedurave Administrative, rezulton se: “Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur”.

Neni 97/3 i ligji nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, parashikon se: “Këshilli i Lartë Gjyqësor zbaton Kodin e Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë në çdo rast ose situatë tjetër që nuk parashikohet shprehimisht nga ky ligj”.

iii. Propozimi i Komisionit

Nisur nga rrethanat e mësipërme, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor të vendosë:

i. Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesave të mëposhtme:

Nr. 2735, 2461, 2421, 324/1, 1006/1 të vitit 2002 (*lapsus gjatë leximit viti 2002, sipas relacionit viti i saktë është 2022*) dhe Nr.729, 1147 të viti 2021 të Gjykatës së Apelit Shkodër.

ii. Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesave:

Nr. 1147, 1206, 1234, 1101 të vitit 2022 dhe kërkesat me Nr. 51, 50 të viti 2023 të Gjykatës së Apelit Durrës:

iii. Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesave:

Nr. 9, 406 (*lapsus gjatë leximit, në relacion është 460*), 589, 540, 449, 456, 461, 458, 459, 466, 439, 425, 429, 469, 619, 684, 652, 1067 të vitit 2022 dhe Nr. 1049, 776/1, 686, 1351, 1050, 1385, 1219, 1187, 1213, 661 të vitit 2021 të Gjykatës së Apelit Korçë.

iv. Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesave:

Nr. 366, 779, 850, 981, 1034, 889, 866, 1069, 403, 350, 301, 424, 476 të vitit 2022 të Gjykatës së Apelit Vlorë.

v. Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesave:

Nr. 914, 910, 776, 804, 775, 805, 757, 969, 919, 864, 957, 956, 955, 954, 953, 854, 855, 852, 777, 733, 798, 799, 797, 796, 778, 921, 899, 940, 2010, 2012, 2015, 2019, 2018, 2016, 2013, 2014, 2010, 941, 945, 767, 760, 766, 768, 763, 764, 431, 261, 545, 563, 446 (*lapsus gjatë leximit, në relacion është 546*), 625, 626/1, 626, 625/1, 616, 627, 712, 713, 1046, 1047, 1034, 1048, 993, 971, 970, 967, 958, 894, 918, 943, 944, 942, 920, 947, 900, 896, 917, 897, 895, 916, 2272, 2264, 2005, 1094, 1073, 1075, 1074, 260, 451, 450, 240, 480, 544 të vitit 2022; Nr. 958, 823, 960, 915, 825, 821, 530, 718, 517, 210, 368, 799, 196, 254, 130, 194, 511, 91, 277, 263 (*lapsus gjatë leximit, në relacion është 763*), 817, 963 të vitit 2021 dhe Nr. 900 të vitit 2020 të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë diskutime ndaj propozimit të Komisionit.

Hidhet në votim akti përkatës dhe miratohet unanimitisht nga anëtarët prezent në mbledhje.

Me ezaurimin e kësaj çështjeje deklarohet e mbyllur mbledhja plenare.

* * *

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor